

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5465
E mërkurë, 2 maj 2018
çmimi 0.40 €

Një shekull dëshpërim: Paqja e papërfunduar në Ballkan

FAQE 10-11



Prof. dr.
Blerim REKA

Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

AKTUALE

E ARDHMJA E UNMIK-UT F. 2

**HARADINAJ U PREMTON
PËRKRAHJE LLADROVCIT
DHE JASHARIT** F. 7

**GDP-JA SHPALOS
DEKLARATËN THEMELUESE
TË PARTISË SË RE** F. 3

**VAZHDOJNË KËRKIMET PËR
DY POLICËT E ZHDUKUR** F. 7

EKONOMI

**AKP-JA SHPËRNDAN FONDET E
20 PËRQINDËSHIT** F. 8

**FORUMI I ARDHSHËM I
BIZNESIT DO TË MBAHET NË
ARABINË SAUDITE** F. 9

KULTURË

**SAMI FRASHËRI, ILUMINIST
MBROJTËS I DITURISË DHE I
SHKENCËS** F. 13

Shkruan: Jahja LLUKA

SPORT

**DRITA KËRKON FITOREN
E TITULLIT KUNDËR GJILANIT** F. 16

**ALTIN ZOGAJ TË SHTUNËN
BOKSON KUNDËR ÇEKUT JANO**

F. 16

FLET PËR "EPOKËN E RE", VALDETE DAKA

FAQE 4-5

Ta fillojmë reformën zgjedhore

Kryetarja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Valdete Daka, e cila është emëruar edhe për një mandat të ri në krye të këtij institucioni, u ka bërë thirrje institucioneve dhe subjekteve politike që sa më shpejt ta fillojnë reformën zgjedhore. Ajo ka thënë se tani është koha më e përshtatshme për të ndodhur ky proces. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Daka ka deklaruar se reforma zgjedhore duhet të bëhet në mes të proceseve zgjedhore dhe jo në prag të tyre. Ajo ka pohuar se pjesë e reformës zgjedhore duhet të jenë lista e votuesve, votimi jashtë Kosovës, votimi me kusht, emërimi i komisionarëve dhe mënyra e numërimit të votave.

Punëtorët kërkojnë nga Qeveria t'ua plotësojë të drejtat

Nën organizimin e Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK-së), punëtorët kanë protestuar në shënimin e Ditës Ndërkombëtare të Punës - 1 Majit. Me pankarta në duar "Qeveri, boll

mo! Zbato ligjet" protestuesit kanë kërkuar kushte më të mira pune. Kryetari i BSPK-së, Avni Ajdini, ka thënë se përmes kësaj proteste ata po kërkojnë nga Qeveria zbatimin e



Ligjit për punëtorët, paga të dinjitetshme, ngritje të pagës minimale në 250 euro, siguri në punë dhe zbatim të kontratës kolektive

FAQE 8-9

Casellati: Do të jem zëri i Kosovës te korporatat e mëdha italiane

Presidentja e Senatit të Italisë, Maria Elisabetta Alberti Casellati, gjatë takimit me kryeparlamentarin Kadri Veseli në Prishtinë, ka bërë me dije se do të jetë zëri i Kosovës te korporatat e mëdha italiane

për të investuar në vendin tonë. Të dy homologët janë pajtuar që marrëdhëniet midis dy parlamenteve të thellohen edhe më tej në të gjitha nivelet e bashkëpunimit parlamentar

FAQE 5

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht-Tetovë
Curtëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

SatStyro
Mushnikovë-Prizren-Kosovë
Product of EPS and XPS
Mob.: +377(0) 44 506 815
Tel&Fax: +381(0) 29 246 030
e-mail: sat.styro@yukon.com
www.satstyro.com

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Pruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302.
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Lu: Politikanët kanë frikë, dikur ishin të paprekshëm

TIRANË, 1 MAJ - Dy shkaqet që kanë vonuar ngritjen e institucioneve si Struktura e Posaçme Antikorrupsion (SPAK) dhe Byroja Kombëtare e Hetimit janë zgjidhur tashmë, ka thënë ambasadori i Amerikës në Tiranë, Donald Lu. Në një deklaratë për "Top Channel" ambasadori amerikan është përgjigjur në pyetjet se çfarë është duke e vonuar ngritjen e Këshillit të Lartë të Gjyqësorit, Këshillit të Lartë të Prokurorisë, SPAK-ut

dhe Byrosë Kombëtare të Hetimit. "Vonesat kanë ardhur për dy arsye. E para, ishte kundërshtimi i Ligjit të Vettingut nga opozita. Ajo e humbi këtë sfidë. E dyta, ishte vonesa për gjetjen e kandidatëve të kualifikuar jashtë sistemit të drejtësisë për anëtarët e KLGJ-së dhe KLP-së. Tashmë të dyja këto çështje janë zgjidhur. Kandidatët për këto institucione janë duke kaluar në procesin e Vettingut. Këto do të jenë funksionale shumë shpe-

jt", ka thënë ambasadori Lu. Ai ka shtuar se nuk është për t'u habitur se politikanët shqiptarë shprehin dyshime për këtë institucion. "Nuk është për t'u habitur që politikanët vazhdojnë të kritikojnë dhe të mbjellin dyshime për këto struktura. Ata dikur ishin të paprekshëm. Tani ata kanë frikë", ka thënë Lu. Ambasadori amerikan ka theksuar se reforma në drejtësi është pika kryesore e misionit të tij diplomatik që prej ditës së parë kur ka ardhur në Shqipëri.



E ardhmja e UNMIK-ut

Vendet anëtare të përhershme të Këshillit të Sigurimit kanë përçarje të thellë sa i përket Kosovës. Tani në Nju Jork po diskutohet për të ardhmen e UNMIK-ut. Ndërkaq ShBA-ja kërkon tërheqjen e këtij misioni

PRISHTINË, 1 MAJ - Edhe Kina mendon se problemi i Kosovës është kompleks. Kështu thuhet në deklaratën e ambasadorit kinez në OKB, MA Zhaoxu, të tre muajve më parë, kur në Këshillin e Sigurimit u diskutua raporti i UNMIK-ut për gjendjen

në Kosovë. "Kina respekton sovranitetin dhe integritetin territorial të Serbisë", thuhet më tej. Kush është kurioz të mësojë çfarë mendon Kina për Kosovën, le të hedhë një sy në faqen e internetit të misionit të përher-

shëm kinez në OKB, e cila ka një kapitull më vete për Kosovën, kjo për ta kuptuar absurditetin e rastit. Për ambasadorin kinez vëmendja e vazhdueshme e KS-së është thelbësore për zgjidhjen e çështjes. Sigurisht se Këshilli i Sigurimit vazhdon të tregojë vëmendje. Për situatën në Kosovë ka mbërritur raporti nga UNMIK-u, i cili pritet të diskutohet ditët e ardhshme. Nuk është bërë e ditur se kur. Një organizatë e afërt me Këshillin e

Sigurimit, Security Council Report, ka njoftuar se shefi i UNMIK-ut, Zahir Tanin, do të informojë për zhvillimet aktuale. Mendohet se Serbia të përfaqësohet në nivel të lartë, ndërkohë që për Kosovën në seancë merr pjesë ambasadorja në ShBA, Vlorë Çitaku.

Në zhvillimet kyçe të tre muajve të kaluar kanë qenë tensionet me arrestimin e Marko Duriçit, protesta e Listës Serbe dhe shtyrja e afatit për zbatimin e marrëveshjes për Asociacionin e Komunave Serbe, vizitat e përfaqësueses së lartë të BE-së, Federica Mogherini në Serbi, marrëveshja e demarkacionit me Malin e Zi, kundërshtimin e Vetëvendosjes ndaj saj, hapja e rrugës për liberalizimin e vizave. Më tej që vrasja e Oliver Ivanoviqit, e cila nuk është zbardhur ende, dhe që prokurori i Gjykatës Speciale ka hequr dorë nga posti.

Roli i UNMIK-ut

UNMIK-u mund të luajë rol duke ndihmuar në zbatimin e marrëveshjeve ekzistuese midis Beogradit dhe Prishtinës. Ka vende anëtare të Këshillit të Sigurimit që mendojnë se raportimi tremujor, siç bëhet aktualisht, nuk ka kuptim dhe që kërkojnë t'i jepet fund misionit. Këshilli i Sigurimit mund t'i shqyrtojë propozimet që bëhen për t'i dhënë fund misionit ose për t'ua ndryshuar formatin takimeve konsultuese. Ose

mund t'i kërkohet sekretarit të përgjithshëm të bëjë një rishikim strategjik të misionit, për të gjetur rrugët e rritjes së efikasitetit të tij. "Ne jemi vazhdimtë në përpjekje për ta përmirësuar situatën. Të presim çfarë do të ndodhë. KS do ta diskutojë raportin pasi të ketë mbërritur", i ka thënë "Deutsche Welles" zëdhënësi i sekretarit të përgjithshëm të OKB-së, Stephane Dujarric.

Këshilli i Sigurimit

Kosova ndiqet me vëmendje kryesisht prej vendeve që kanë interes në rajon. Organizata mbirajonale si BE-ja, NATO-ja dhe OSBE-ja luajnë aktualisht rol gjithnjë e më të madh në Kosovë. Vendet anëtare të përhershme të Këshillit të Sigurimit kanë përçarje të thella sa i përket Kosovës. Franca, Mbretëria e Bashkuar dhe ShBA-ja e kanë njohur pavarësinë dhe mbështesin Qeverinë e Kosovës, ndërkohë që Kina dhe Rusia nuk e pranojnë pavarësinë dhe mbështesin pozicionin e Serbisë. ShBA-ja kërkon tërheqjen e UNMIK-ut, duke përmendur stafin e madh për përgjegjësi të vogël. Për këtë modifikim i mandatit të UNMIK-ut do të sillte përmirësim të situatës. Çdo lloj përpjekje për ta ndryshuar statusin e UNMIK-ut do të kërkonte rezolutë të re, gjë që bllokohet prej Rusisë. Çfarë qëndrimi do të mbante Kina, nuk dihet.



Vasili: Kryeministri ka vdekur politikisht

TIRANË, 1 MAJ - Kreu i grupit parlamentar i Lëvizjes Socialiste për Integritim (LSI), Petrit Vasili, përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka

shkruar se Departamenti Amerikan i Shtetit ka folur qartë se Shqipëria është kthyer në një lavatriçe gjigante të pastrimit të parave të drogës,

trafikut të qenieve njerëzore dhe krimin të organizuar. "Ky kryeministër që ekonominë kombëtare e shkatërron në emër të pastrimit të parave të

zeza të krimit ka vdekur politikisht", ka thënë ai. Vasili ka shtuar se koha e Edi Ramës si kryeministër ka mbaruar.



Bëhet publike deklarata e parimeve mbi bazën e së cilës do ta vazhdojë rrugëtimin politik Grupi i Deputetëve të Pavarur (GDP)

GDP-ja shpalos deklaratën themeluese të partisë së re

Grupi i Deputetëve të Pavarur (GDP), që para pak kohe janë larguar nga Lëvizja Vetëvendosje, kanë shpalosur të martën deklaratën themeluese të partisë së re. Dy deputetët e këtij grupi parlamentar, Visar Ymeri dhe Dukagjin Gorani, nuk kanë treguar për emrin e partisë, por kanë theksuar se partia e re do të jetë një subjekt i majtë politik, i cili do të angazhohet për një republikë zhvillimore dhe qytetare

EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 1 MAJ - Deputetët e Grupit të Deputetëve të Pavarur (GDP), Visar Ymeri dhe Dukagjin Gorani, kanë shpalosur të martën deklaratën e parimeve të partisë së re mbi bazën e së cilës ky grup parlamentar do ta vazhdojë aktivitetin politik.

Ish-deputetët e Lëvizjes Vetëvendosje në një konferencë për medie kanë vlerësuar se kjo deklaratë përmbledhë pikënisjet e tyre ideore, synimet shoqërore dhe strategjinë publike për angazhimin e tyre politik.

Deputeti Visar Ymeri ka thënë se forma e rrugëtimin politik të GDP-së do të bëhet e ditur në të ardhmen. Sipas tij, rrugëtimi i këtij grupi politik do të ketë për bazë dy çështje esenciale. "Në cilëndo formë të këtij rrugëtimi politik, dy gjëra janë të qarta: një që ne do të kemi të ardhme politike dhe, e dyta, që angazhimi ynë do të jetë përbrenda këtij koncepti, përbrenda këtyre vlerave që po i shpalosim sot", ka thënë Ymeri.

Ai ka theksuar se Kosova duhet të jetë republikë qytetare dhe zhvillimore. "Ne e pranojmë domosdoshmërisht konceptin e ekonomisë së tregut, por jemi të vetëdijshëm se është i kufizuar. Për ne liria dhe barazia janë të pandashme. Kosova duhet të jeta republikë e qytetarëve dhe republikë zhvillimore. Ne angazhohemi dhe do të punojmë në partneritet me shqiptarët dhe me grupet e tjera. Kjo deklaratë e parimeve mbledh në vete një grup të njerëzve. Ne do të kemi një të ardhme politike dhe do të veprojmë në bazë të këtyre parimeve", është shprehur Ymeri.

I pyetur nga gazetarët për emrin e partisë së re, Ymeri ka thënë se ende nuk kanë vendosur për një gjë të tillë. "Nuk është vendosur

ende. Ka disa opsione që janë duke u diskutuar dhe shumë shpejt do ta bëjmë publik vendimin", ka deklaruar Ymeri.

Më tutje, Ymeri ka theksuar se tashmë kanë identifikuar edhe bashkëpunëtorë të shumtë nëpër komunat e Kosovës, me të cilët do të angazhohen për strukturimin e partisë së re. "Kemi bashkëpunëtorë që jetojnë në komuna të ndryshme të Kosovës, të cilët punojnë bashkë me ne. Kjo do të marrë një hov të veçantë për strukturimin tonë në terren. Forma e strukturuar merr pak kohë", është shprehur ai.

Ymeri, i cili dikur ka qenë kryetar i Lëvizjes Vetëvendosje, nuk ka përjashtuar bashkëpunimin me këtë parti. Sipas tij, nëse LV-ja nuk do të bashkëpunojë, atëherë ata nuk do ta detyrojnë për një gjë të tillë. Ndërsa deputeti tjetër i GDP-së, Dukagjin Gorani, ka shpalosur parimet themelore të partisë së re. "Në parim, në këtë deklaratë angazhohemi për një republikë qytetare, ku të gjithë gëzojnë të drejtat e njëjta", ka thënë Gorani. Ai ka thënë se Kosova i takon çdo qytetari që jeton në të, pavarësisht përkatësisë etnike. "Ne në çdo gjeneratë shohim përgjegjësi për fatin e vendlindjes së përbashkët. Refuzojmë çdo paragjykim të bazuar në etni e religjion. Në çdo kohë shpresoj të ngitemi. Besojmë se sovraniteti u takon qytetarëve dhe pushteti demokratik buron prej tyre", është shprehur Gorani.

Ai ka theksuar se do të angazhohen që çdo anëtar i komuniteteve të punojë bashkë me ta në mënyrë që të mbrohen të drejtat e tyre. "Kështu hapim rrugë për bashkëjetesë të qëndrueshme. Konsiderojmë se një qasje e tillë reformatore do t'i inkurajonte edhe partitë e tjera të sigurojnë një qasje të tillë që të punojnë në të mirë të qytetarëve", ka deklaruar Gorani.



Së fundi është raportuar nëpër media se ky subjekt politik do të quhet Partia Social Demokrate. Madje javën e kaluar deputeti i këtij grupi parlamentar, Fisnik

Ismaili, është kapur nga mediet në Kuvend duke ua treguar kolegëve të tij logon e kësaj partie me akronimin PSD. Ky grup parlamentar ka 12 deputetë, të cilët

janë larguar nga Lëvizja Vetëvendosje pas mospajtimeve që kishin ndodhur në këtë parti rreth rikthimit të Albin Kurtit në krye të Lëvizjes Vetëvendosje.

Lekaj, mërgimtarëve: Keni kujdes me rezervimin e biletave

PRISHTINË, 1 MAJ (ER) - Ministria e Infrastrukturës përmes një videosazhi ka dhënë disa këshilla për mërgimtarët lidhur me aviokompanitë që bëjnë

rezervimin e biletave. Ministri i Infrastrukturës, Pal Lekaj, ka shkruar në llogarinë e vet në "Facebook" se mërgimtarët është e rëndësishme të kenë

kujdes se te cila aviokompani bëjnë rezervimin e biletave. "Tani është koha e pushimeve dhe diaspora jonë i drejtohet vendlindjes. Për të gjithë ju të

nderuar mërgimtarë, është e rëndësishme të keni kujdes se te cila aviokompani bëni rezervimin e biletave", ka shkruar Lekaj.



Flet për "Epokën e re", Valdete Daka

Ta fillojmë reformën z

Kryetarja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Valdete Daka, e cila është emëruar edhe për një mandat të ri në krye të këtij institucioni, u ka bërë thirrje institucioneve dhe subjekteve politike që sa më shpejt të fillojnë reformën zgjedhore. Ajo ka thënë se tani është koha më e përshtatshme për të ndodhur ky proces. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Daka ka deklaruar se reforma zgjedhore duhet të bëhet në mes të proceseve zgjedhore dhe jo në prag të tyre. Ajo ka pohuar se pjesë e reformës zgjedhore duhet të jenë lista e votuesve, votimi jashtë Kosovës, votimi me kusht, emërimi i komisionarëve dhe mënyra e numërimit të votave. Daka ka thënë se pa vullnet politik nuk do të ketë reformë zgjedhore. Ajo ka bërë me dije se synim kryesor i KQZ-së mbetet puna sa më e mirë e procesit zgjedhor

EPOKA E RE **Shqipe HETEMI**

PRISHTINË, 1 MAJ - Kryetarja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Valdete Daka, ka thënë të martën se nën drejtimin e saj ky institucion do të jetë më efikas gjatë këtij mandati. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ajo ka bërë me dije se synim kryesor do ta ketë perfeksionimin e procesit zgjedhor. "Është nder i madh për mua ta drejtoj Komisionin Qendror të Zgjedhjeve edhe për një mandat. Në momentin që të kompletohem si KQZ do të merremi me çështje të cilat na kanë mbetur, pra me rekomandimet e vëzhguesve vendorë dhe ndërkombëtarë. Rekomandimet e tyre do t'i zbatojmë në përpikëri. Synim kryesor do ta kemi perfeksionimin e procesit zgjedhor", ka deklaruar Daka, duke shtuar se do ta japë maksimumin për t'i kaluar me sukses të gjitha sfidat. "Kurrë nuk dihet se çfarë sfidash na presin. Edhe pse unë jam gjatë në krye të KQZ-së, megjithatë asnjëherë nuk mund të them se hyj në proces zgjedhor pa frikë. Gjithmonë ekziston frika se si institucion mund të dështojmë, pastaj barra më e madhe bie mbi mua si kryetare e KQZ-së. Por, do të përpiqem ta jap maksimumin për t'i tejkaluar të gjitha sfidat", është shprehur ajo. Daka u ka bërë thirrje institucioneve dhe subjekteve politike që sa më shpejt ta fillojnë reformën zgjedhore pasi, sipas saj, tani është koha më e përshtatshme për të ndodhur ky proces. "Nëse ka vullnet politik nga subjektet politike në pozitë dhe opozitë për të pasur një reformë zgjedhore të mirëfilltë ne do ta japim kontributin tonë, mirëpo pa vullnet politik nuk ka reformë

zgjedhore. Unë si kryetare e KQZ-së në vazhdimësi u kam bërë thirrje politikanëve dhe institucioneve ta fillojnë reformën zgjedhore sepse kjo ka qenë një prej rekomandimeve kryesore nga vëzhguesit vendorë dhe ata ndërkombëtarë. Ka çështje teknike të cilat me shumë pak ndryshime do të rregullohen dhe do ta përmirësonin procesin zgjedhor", ka theksuar ajo. Daka ka thënë se pjesë e reformës zgjedhore duhet të jenë lista e votuesve, votimi jashtë Kosovës, votimi me kusht, emërimi i komisionarëve, mënyra e numërimit të votave si dhe çështje të tjera.

"Epoka e re": Znj. Daka, edhe për një mandat ju do të drejtoni Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ). Pse vendoset që edhe për shtatë vjet të tjera të jeni në krye të këtij institucioni?

Daka: Është nder i madh për mua ta drejtoj Komisionin Qendror të Zgjedhjeve edhe për një mandat. Në mandatin e kaluar kemi kryer një punë të madhe. KQZ-ja nën drejtimin tim ka kaluar sfida të shumta, kemi pasur dështime, por edhe suksese të mëdha. Si institucion kemi arritur t'i tejkalojmë të gjitha mospajtimet profesionale dhe partiake. Kemi organizuar shumë cikle të zgjedhjeve të cilat janë vlerësuar me notë të lartë si nga vëzhguesit vendorë, po ashtu edhe nga ata ndërkombëtarë. Sidomos në vitet e fundit kemi përmirësuar imazhin e shtetit të Kosovës duke organizuar zgjedhje të lira dhe demokratike.

"Epoka e re": Cilët do të jenë hapat kryesorë që do të ndërmerri gjatë këtij mandati?

Daka: Sapo të kompletohem si KQZ do të merremi me çështje të cilat na kanë mbetur, pra me



rekomandimet e vëzhguesve vendorë dhe ndërkombëtarë. Rekomandimet e tyre do t'i zbatojmë në përpikëri. Synim kryesor do ta kemi perfeksionimin e procesit zgjedhor. Natyrisht se do të punojmë edhe në listën e votuesve dhe në të gjitha aspektet për të cilat kemi pasur vërejtje në proceset e kaluara zgjedhore. Pasi të emërohen anëtarët e KQZ-së do ta vazhdojmë punën me intensitet të lartë, meqë kemi shumë punë edhe jashtë zgjedhjeve. Do të merremi me infrastrukturën ligjore dytësore, do t'i përmirësojmë të gjitha ato për të cilat kemi vërejtje në raportet e vëzhguesve vendorë dhe ndërkombëtarë, në mënyrë që të përmirësohet procesi zgjedhor.

"Epoka e re": Pra, KQZ-ja në këtë mandat do të jetë më efikase në punën e saj?

Daka: Shpresoj se do të jetë më efikase dhe për këtë do ta japë maksimumin tim. Ashtu siç kam punuar deri më tash, do të punoj edhe më tutje së bashku me anëtarët e rinj të KQZ-së, të cilët

besoj se shumë shpejt do të emërohen. Me këtë rast i falënderoj të gjithë anëtarët të cilët kanë qenë në KQZ për bashkëpunimin, institucionet dhe mediet.

"Epoka e re": Prisni që këtë vit të ketë reformë zgjedhore?

Daka: Nëse ka vullnet politik nga subjektet politike në pozitë dhe opozitë për të pasur një reformë zgjedhore të mirëfilltë ne do ta japim kontributin tonë. Mirëpo pa vullnet politik nuk ka reformë zgjedhore. Unë si kryetare e KQZ-së në vazhdimësi u kam bërë thirrje politikanëve dhe institucioneve të fillojnë me reformën zgjedhore, sepse kjo ka qenë një prej rekomandimeve kryesore nga vëzhguesit vendorë dhe ata ndërkombëtarë. Ka çështje teknike të cilat me shumë pak ndryshime do të rregullohen dhe do ta përmirësonin procesin zgjedhor.

"Epoka e re": Është koha e duhur që tani të nisë procesi i reformës?

Daka: Po, sepse reforma zgjed-

hore duhet të bëhet në mes të proceseve zgjedhore dhe jo në prag të tyre. Pra, në mes të cikleve zgjedhore preferohet të bëhet reforma zgjedhore në mënyrë që të kemi mundësi t'i informojmë votuesit si dhe partitë politike të jenë të informuara lidhur me ndryshimet eventuale.

"Epoka e re": Cili do të jetë efekti kryesor i kësaj reforme?

Daka: Varet se çfarë reforme do të kemi. Reformat gjithmonë bëhen për të avancuar në procese dhe varësisht nga ajo se sa do të kemi mundësi të bëjmë reformë aq do të jetë edhe efekti në zgjedhjet e ardhshme.

"Epoka e re": Çfarë duhet të përfshijë reforma?

Daka: Lista votuese, votimi jashtë Kosovës dhe votimi me kusht kanë qenë pikat më neuralgjike të procesit zgjedhor. Duhet të ketë reformë edhe sa i përket emërimit të komisionarëve sepse e dimë se në shumicën e rasteve dobësia më e madhe ka qenë tek numërimi i

gjedhore

Casellati: Do të jem zëri i Kosovës te korporatat e mëdha italiane

Presidentja e Senatit të Italisë, Maria Elisabetta Alberti Casellati, gjatë takimit me kryeparlamentarin Kadri Veseli në Prishtinë, ka bërë me dije se do të jetë zëri i Kosovës te korporatat e mëdha italiane për të investuar në vendin tonë. Të dy homologët janë pajtuar që marrëdhëniet midis dy parlamenteve të thellohen edhe më tej në të gjitha nivelet e bashkëpunimit parlamentar

EPOKA ERE

Faton DERMAKU

PRISHTINË, 1 MAJ - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka pritur të martën në takim presidenten e Senatit të Italisë, Maria Elisabetta Alberti Casellati, me të cilën ka biseduar për zhvillimet politike, perspektivën evropiane të Kosovës, në mënyrë të veçantë për marrëdhëniet bilaterale të cilat ekzistojnë midis dy vendeve dhe parlamenteve respektive. Duke e falënderuar Casellatin për vizitën e saj të parë në Kosovë pas marrjes së detyrës së re, Veseli ka thënë se Republika e Kosovës i konsideron vlera të veçanta

raportet shumë të mira që ka ndërtuar me shtetin italian. Ai ka thënë se këto raporte kanë ndikim pozitiv në rrugën e Kosovës drejt integriteteve euroatlantike.

Më tutje, kryeparlamentari Veseli e ka informuar Casellatin se Kosova i ka plotësuar tashmë të gjitha kriteret për liberalizimin e vizave dhe është në prag të marrjes së vendimit pozitiv nga ana e BE-së ndërsa, siç ka thënë ai, në këtë proces qëndrimi i Italisë është shumë i rëndësishëm.

Ndërsa presidentja e Senatit të Italisë, Maria Elisabetta Alberti Casellati, ka thënë se shteti italian e ka mbështetur dhe do të vazhdojë ta mbështesë

Kosovën në rrugën e saj drejt integriteteve euroatlantike. Ajo ka thënë se përpos bashkëpunimit politik dhe atë në fushën e sigurisë, Italia do ta mbështesë Kosovën edhe më shumë në fushën ekonomisë. "Unë do të jem zëri i Kosovës te korporatat e mëdha italiane që të vijnë e të investojnë në Kosovë", ka thënë ajo.

Të dy homologët janë pajtuar që marrëdhëniet midis dy parlamenteve të thellohen edhe më tej, në të gjitha nivelet e bashkëpunimit parlamentar. Në fund të këtij takimi, presidentja e Senatit italian e ka ftuar kryeparlamentarin Veseli për vizitë zyrtare në Romë.



votave në vendvotime nga militantët politikë të cilët e kanë shtrembëruar procesin zgjedhor, sidomos kur ka qenë çështja te kandidatët qoftë për Kuvend apo për asamble komunale. Kjo na ka shkaktuar shumë vonesa, pastaj edhe në shpalljen përfundimtare të rezultateve. Është pastaj edhe mënyra e numërimit të votave, si dhe shumë çështje të tjera të cilat kanë nevojë të reformohen. Ndoshta nuk ka nevojë të bëhen reforma rrënjësore, sepse ka shumë çështje teknike sa i përket sistemit zgjedhor që mund të rregullohen shumë lehtë.

"Epoka e re": Mendoni se më nuk duhet të mbahen asnjë palë zgjedhje pa reformë zgjedhore?

Daka: Reforma është çështje që iu përket partive politike, kurse ne si KQZ kemi obligim të mbajmë zgjedhje dhe t'i organizojmë ato në mënyrën më të mirë. Prandaj nëse do të ketë apo jo reformë zgjedhore do të

vendosin subjektet politike dhe institucionet relevante. Me pak vullnet politik dhe pak përkushtim të institucioneve ka shumë çështje që mund të rregullohen. Megjithatë, kurdo që mbahen zgjedhjet, me apo pa reformë, unë dhe anëtarët e KQZ-së do të angazhohemi që ato të jenë të lira dhe demokratike. Prandaj shpresoj se zgjedhjet e ardhshme të jenë zgjedhjet më të mira që i kemi organizuar ndonjëherë kurdo që mbahen ato.

"Epoka e re": Çfarë do të jetë sfida për ju në këtë mandat?

Daka: Kurrë nuk dihet se çfarë sfidash na presin. Edhe pse jam gjatë në krye të KQZ-së, megjithatë asnjëherë nuk mund të them se hyj në proces zgjedhor pa frikë. Gjithmonë ekziston frika se si institucion mund të dështojmë, pastaj barra më e madhe bie mbi mua si kryetare e KQZ-së. Por, gjithsesi do të përpiqem ta jap maksimumin tim për t'i tejkaluar të gjitha sfidat.



Vetëvendosja, aksion simbolik për mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve



"Për katër muaj të këtij viti kanë vdekur katër punëtorë në vendin e punës. Vitin e kaluar 17. Vetëm në KEK që nga paslufta kanë vdekur 43 punëtorë në vend të punës", ka thënë të martën anëtarja e kryesisë së Lëvizjes Vetëvendosje, Nazlie Bala

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 1 MAJ - Lëvizja Vetëvendosje (LV) në Ditën Ndërkombëtare të Punës ka organizuar një aksion simbolik për papunësinë në Kosovë dhe

për gjendjen e mjerueshme të punëtorëve. Me këtë rast, anëtarja e kryesisë së Lëvizjes Vetëvendosje, Nazlie Bala, ka thënë se sot, kur duhet të flasim për të drejtat dhe gjendjen e punëtorëve, nuk mund të mos flasim edhe për varfërinë.

"Kosova vazhdon të jetë vend i varfër. Mbretërojnë papunësia dhe pabarazia ekonomike, sepse qeveritarët e kanë për synim pasurimin e vet dhe jo zhvillimin ekonomik. Një vend me gjendje të tillë dihet se nuk ka kushte për punëtorët sepse të drejtat e punëtorëve janë të lidhura ngushtë me papunësinë. Sa më shumë të papunë, aq më i pasigurt punësimi edhe për ata që janë në punë, sepse mund të zëvendësohen lehtë e shpejtë. Sepse ai që s'ka rrogë fare, lehtë e pranon rrogën e keqe, e ndonjëherë i mbyll sytë

e veshët edhe përballë abuzimit nga shefi", është shprehur ajo.

Bala ka theksuar se papunësia e madhe paraqet rrezik që të punësuarit ta humbin punën, që është burim i vetëm i të hyrave për familje. "Kjo i shtyn ata ta pranojnë gjendjen e mjerueshme e të papërmirësueshme qofshin punëtorë në arkat e marketeve, qofshin punëtorë të minierave, qofshin taksistë, punëtorë sigurimi apo infermiere", ka thënë Bala, duke shtuar se kufizimi i orarit të stërzgatur të punës, ndalja e

punësimit pa kontratë pune, kryerja me rregull e pagave nuk janë refrene të ankimit, por kërkesa të qarta e të drejta që kërkojnë zbatim të menjëhershëm. "Për katër muaj të këtij viti kanë vdekur katër punëtorë në vendin e punës. Vitin e kaluar 17. Vetëm në KEK që nga paslufta kanë vdekur 43 punëtorë në vend të punës. Çfarë është kjo moskokëçarje e shtetit dhe e privatit për punëtorët? Në këtë vend ku po e qeveris shtetin dhe ekonominë hajnia, duket sikur punëtorëve u është shpallur luftë!", ka thënë Bala.

Policët e Kosovës, pa sigurim shëndetësor e jetësor

PRISHTINË, 1 MAJ - Që nga themelimi i Policisë së Kosovës, 18 vjet më parë, deri më tani, 17 pjesëtarë të saj kanë humbur jetën në vendin e tyre të punës, derisa numri i policëve të lënduar në kryerje të detyrës konsiderohet të jetë më i madh. Së fundi dy policë të Kosovës, gjatë kryerjes së detyrës zyrtare, janë aksidentuar në rrugën magjistrale Hani i Elezit - Kaçanik, e të cilët kanë rënë në rrjedhën e lumit Lepenc.

Kërkesa për sigurim shëndetësor dhe aksidental për Policinë e Kosovës është e kamotshme, por deri më tani asnjë nga qeveritë e deritashme të Kosovës nuk ka arritur ta plotësojë.

Kryetari i Sindikatës së Policisë së Kosovës, Shaban Tasholli, në një prononcim për "Radion Evropa e Lirë" ka thënë se rasti i fundit i policëve të aksidentuar ngre nevojën e krijimit të sigurimeve shëndetësore e aksi-

dentale për policët. "Disa herë edhe në qeveritë e mëhershme edhe tani kemi bërë kërkesat tona për sigurim shëndetësor dhe aksidental. Asnjëherë nuk na është thënë se nuk do të bëhen, por asnjëherë nuk janë bërë. Kemi qenë të shqetësuar, por me rastin e fundit jemi edhe më të shqetësuar, jemi të pakënaqur me atë që është bërë në këtë çështje. Jemi Policia e vetme në botë që nuk kemi sigurim shëndetësor", ka thënë Tasholli.

Në kryerje të detyrës shumë herë policët në Kosovë, thotë Tasholli, kanë qenë të rrezikuar apo janë lënduar dhe mungesa e sigurimit shëndetësor dhe aksidental ka vështirësuar trajtimin e tyre mjekësor apo të shërbimit për familjarët e policëve që kanë humbur jetën. Njohës të çështjeve të sigurisë në Kosovë e shohin urgjente krijimin e sigurimeve shëndetësore dhe jetësore për pjesëtarët



e Policisë së Kosovës. Eksperti i çështjeve të sigurisë, Naim Maloku, thotë për "Radion Evropa e Lirë" se Qeveria e Kosovës duhet urgjentisht të sjellë në Kuvend Ligjin për sigurime shëndetësore dhe jetësore të policisë. "Problemi i sigurimeve shëndetësore për Policinë daton që kur është miratuar Ligji për policinë dhe nuk është zgjidhur.

Që nga atëherë ka pasur kërkesën nga Sindikata e Policisë dhe ai problem nuk është zgjedhur. Me këta dy policë të aksidentuar e të zhdukur, numri i policëve që kanë humbur jetën në detyrë shkon mbi 17, e që familjarët e tyre nuk kanë asnjë kompensim. Është e metë e madhe edhe për Policinë që nuk e ka të siguruar jetën", ka deklaruar Maloku.

Sipas Malokut, është e pajustificueshme që Policia e Kosovës edhe pas 18 vjetësh prej themelimit të mos ketë as edhe sigurimin shëndetësor. "Ne kemi pasur probleme të lëndimit të policëve në protestat e dhunshme që u bënë në Kosovë dhe sipas njohurive që i kam, as lëndimet e tyre nuk janë trajtuar si duhet. E di një rast që ka pagur 6 000 euro për t'u shëruar në spitale private dhe nuk e ka kompensuar shteti. Kjo është një e metë e madhe edhe për efikasitetin e tyre në detyrë, për shkak se polici e di që nuk e ka jetën e siguruar dhe nuk ka sigurim shëndetësor", ka thënë Maloku.

Megjithatë, policia e Kosovës mbetet e përkushtuar për përbushjen e vizionit dhe misionit të saj, për zbatimin e ligjit dhe Kushtetutës së vendit, për garantimin e rendit dhe sigurisë, në mënyrë që të ofrojë shërbim efikas policor dhe profesional për të gjithë qytetarët.

Haradinaj u premton përkrahje Lladrovci dhe Jasharit

Kryeministri Ramush Haradinaj ka vizituar të martën Komunën e Drenasit dhe të Skenderajt. Ramiz Lladrovci dhe Bekim Jashari kanë falënderuar kryeministrin për këtë vizitë dhe kujdesin për të ndihmuar me projekte këto dy komuna. Kryeministri Haradinaj ka theksuar se marrëdhëniet komunë qeveri do të kalojnë në nivel të ri

EPOKA
ERE

Arbisa SHEFKIU

DRENAS/SKENDERAJ, 1 MAJ - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka vizituar të martën Parkun e Biznesit në Drenas, i shoqëruar edhe nga kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci. Pas vizitës që i ka bërë Parkut të Biznesit, ku ka parë nga afër punët dhe projektet konkrete që janë duke u zhvilluar në këtë park, Haradinaj ka vizituar Komunën e Drenasit.

Pas takimit me kryetarin e

komunës, kryeministri Haradinaj për mediet ka treguar se u bisedua për të gjitha projektet zhvillimore në Drenas dhe mundësinë e financimit të tyre, por edhe për temat zhvillimore që ndërlidhen edhe me pronën. "Komuna e Drenasit ka projekte zhvillimore, por kërkon që një pjesë e pronave, që tani janë në pronësi të AKP-së ose mekanizmave të tjerë, t'i kthehen komunës për shkak se në këtë mënyrë do të ishte në interes të zhvillimit", ka theksuar kryeministri Haradinaj, duke besuar se do të gjendet zgjidhja e



duhur në bazë të ligjit.

Kryeministri ka takuar edhe sindikalistët e ndërmarrjes "Ferronikel"-i, të kryesuar nga kryetari Fehmi Nika, nga të cilët u informua për gjendjen në këtë ndërmarrje. "Konstatuam se Qeveria i ka borxh 'Ferronikel'-it një shumë të caktuar mjeteshe financiare, është një rimbursim i TVSh-së, me të cilin lidhen edhe pagat për muajin mars dhe prill", është shprehur kryeministri Haradinaj, duke shtuar se është me interes që "Ferronikel"-i të

vazhdojë të funksionojë pasi në të punojnë 820 punëtorë. Ndërkaq kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, pasi ka garantuar kryeministrin Haradinaj që projektet që do të vijnë, do ta zhvillojnë këtë komunë, tha se çdo investim që do të vijë nga Qeveria do të zhvillohet në mënyrën më të shpejtë të mundshme. Po të martën kryeministri Ramush Haradinaj ka vizituar Komunën e Skenderajt, ku është pritur nga kryetari i kësaj

komune, Bekim Jashari, me bashkëpunëtorë, duke u njoftuar nga afër për të gjitha aspektet zhvillimore të kësaj komune. Duke pasur parasysh kontributin dhënë për lirinë e atdheut dhe veprën heroike, flajmin heroik e legjendar të familjes Jashari, kryeministri tha se obligohemi të gjithë për këtë komunë. "Përgëzoj kryetarin Jashari për një shkollë të re qeverisëse, që vërtet është një shkollë që u dedikohet temave zhvillimore të komunës dhe qytetarëve", ka thënë kryeministri Haradinaj. Ai ka shtuar se me kryetarin Jashari diskutuan për shumë projekte të kësaj komune, si shtëpinë e kulturës, palestrën sportive, ujin e pijshëm dhe Parkun e Biznesit. Kryeministri Haradinaj ka thënë se marrëdhëniet komunë - qeveri do të kalojnë në nivel të ri, duke ftuar kryetarin me qeverinë e tij komunale të zhvillojnë një takim në mbledhjen e Qeverisë së vendit për t'i paraqitur projektet, shqetësimet e ndryshme të Komunës së Skenderajt.

Ndërkaq, kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, ka falënderuar kryeministrin Haradinaj për mbështetjen që po i jep kësaj komune, por edhe të gjitha komunave të Kosovës. Qeveria në bashkëpunim me Komunën e Skenderajt do ta bëjë zhvendosjen e trupave të dëshmorëve nga fshati Polac në Kompleksin Memorial të dëshmorëve në fshatin Marinë të Skenderajt, kurse bartjen e tyre do ta bëjë FSK-ja.



Vazhdojnë kërkimet për dy policët e zhdukur

PRISHTINË, 1 MAJ (ER) - Për të tretën ditë me radhë policia, Forca e Sigurisë së Kosovës dhe qytetarë vullnetarë kanë zhvilluar kërkimet për dy policët e zhdukur të aksidentuar me veturë zyrtare në magjistralen Hani i Elezit - Kaçanik të cilët kanë rënë në rrjedhën e lumit Lepenc. Policët e aksidentuar të shtunën kanë qenë në një makinë zyrtare në magjistralen Kaçanik - Hani i Elezit dhe më pas vetura ka rënë nga ura e lumit Lepenc.

Kërkimet po bëhen edhe në anën e kufirit me Maqedoninë. Autoritetet atje janë në kërkim për gjetjen eventuale të trupave të dy policëve, pasi dyshimet janë që rrjedha e ujit ka mundur t'i bartë trupat e policëve.

Zëvendëskryeministri i parë i Kosovës, Behgjet Pacolli, ka vizituar të martën ekipet e kërkim-shpëtimit të cilat janë duke punuar për gjetjen e dy policëve të cilët para disa ditësh kanë pësuar një aksi-



dent në afërsi të lumit Lepenc. "Pas kthimit tim nga rruga, sot, bashkë me ministrin e Brendshëm, Bejtush Gashi,

shkova në vendin ku pësuan aksident dy policët e Kosovës, Malsor Dashi dhe Armend Trena. Ekipet e policisë, të FSK-

së dhe vullnetarët alpinistë po vazhdojnë kërkimet e tyre. Vizitova edhe familjet e dy policëve duke u munduar

sadopak t'u qëndroj pranë në këto çaste pritjeje dhe ankthi", ka shkruar Pacolli në llogarinë e vet në "Facebook".

Punëtorët kërkojnë nga Qeveria

Nën organizimin e Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSK), punëtorët kanë protestuar në shënimin e Ditës Ndërkombëtare të Punëtorëve - 1 Majit. Me pankarta në duar "Qeveri, boll mo! Zbato ligjet" protestuesit kanë kërkuar kushte më të mira pune. Kryetari i BSPK-së, Avni Ajdini, ka thënë se përmes kësaj proteste ata po kërkojnë nga Qeveria zbatimin e ligjit për punëtorët, paga të dinjitetshme, ngritjen e pagës minimale në 250 euro, siguri në punë dhe zbatim të kontratës kolektive

EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 1 MAJ - Me moton "Qeveri, boll mo! Zbato ligjet", punëtorët kanë protestuar në shënimin e Ditës Ndërkombëtare të Punës - 1 Maj. Protesta, e cila ishte organizuar nga Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK), mbledhi pak punëtorë të martën në sheshet e Prishtinës.

Kryetari i BSPK-së, Avni Ajdini, ka thënë se përmes kësaj proteste ata po kërkojnë nga Qeveria zbatimin e Ligjit për punëtorët, paga të dinjitetshme, ngritjen e pagës minimale në 250 euro, siguri në punë dhe zbatim të kontratës kolektive. Madje ai ka paralajmëruar se do të merren masa nëse Qeveria nuk respekton kërkesat e tyre. "Kjo ditë është arritur me gjak kur punëtorët kanë kërkuar të drejtat e veta.

Punëtorët kanë luftuar duke i thënë stop skllavërimit, kurse ne sot i themi boll Qeverisë. Ne jemi sot unikë. Mesazhi është të zbatohet ligji, të ngrihet paga minimale në 250 euro, të njihet përvoja e punës për vitet e '90-ta", ka thënë ai.

Ajdini ka shtuar se sot punëtorët paguhën për 8 orë punë, kurse ata punojnë 12 orë. "Nëse nuk i kërkojmë të drejtat tona ato nuk do të realizohen. Nuk ka askund në botë që 75 euro të merret një pension. Kjo vjen për arsye se nuk kemi kërkuar të drejtat tona. Kjo nuk do të jetë protesta e vetme. Nëse nuk realizohen kërkesat tona nuk do ta presim 1 majin për protesta më masive", ka thënë Ajdini. Kurse Shukrie Regjepi nga rrjeti i gruas në BSPK ka thënë se duhet të njihen edhe të drejtat e grave.

Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Punës - 1 Majin, përfaqësuesit e institu-

cioneve të vendit janë zotuar se do të krijojnë kushte më të mira për punë. Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka deklaruar se shteti duhet të ketë një përkujdesje më dinjitoze për të gjitha kategoritë shoqërore pasi, sipas tij, shtylla më e fortë e ekonomisë dhe e shtetit janë punëtorët. "Çdo punëtor në Kosovë sot vlerësohet më shumë se në të kaluarën. I kemi rritur disa herë pagat dhe tash ato janë pothuajse në nivel të barabartë me vendet e rajonit. Kemi hartuar ligje moderne që mbrojnë të drejtat e punëtorëve, por kërkojmë një zbatim dhe monitorim më i mirë i tyre. Varësisht prej vendeve dhe kulturave të tyre, ka pikëpamje të ndryshme për 1 majin, por kjo ditë gjithmonë është festuar te ne. Duke ua uruar të gjithëve festën, unë ndaj shqetësimit me të gjithë punëtorët, si të sektorit publik, ashtu edhe të



atij privat, si dhe u bashkohem kërkesave të tyre për kushte më të mira të punës dhe të drejta më shumë për punëtorët. Si shtet i ri duhet të kemi një përkujdesje më dinjitoze për të gjitha kategoritë shoqërore, ku shtylla më e fortë e ekonomisë dhe Republikës sonë pa dyshim se janë punëtorët", ka thënë Thaçi në një deklaratë për medie.

Edhe zëvendëskryeministri dhe kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka thënë se është obligim i shtetit të Kosovës t'u krijojë kushte më të mira punëtorëve si dhe t'u garantohen të drejtat. Ai ka kërkuar që punëtorët si në sektorin publik, po ashtu edhe në atë privat, të vlerësohen edhe më shumë për

punën e tyre. Limaj ka thënë se e përkrah çdo nismë të sindikatave të cilat çojnë në përmirësimin e kushteve për punëtorët.

Ndërkaq ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), Skender Reçica, ka garantuar punëtorët se ministria që drejton nuk do të mbetet spektatore karshi të drejtave të tyre. "Në këtë ditë të shënuar dua që t'i garantoj të gjithë punëtorët se shteti ynë dhe ministria që unë drejtoj nuk të mbeten vetëm spektatorë duke shikuar nëse po zbatohen këto të drejta, por do të jenë mbrojtës të fuqishëm të të drejtave të tyre", ka thënë Reçica.

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, të martën ka pritur në takim përfaqësue-

AKP-ja shpërndan fondet e 20 përqindëshit

PRISHTINË, 1 MAJ (ER) - Agjencia Kosovare e Privatizimi (AKP) ka përgatitur dokumentacionin përkatës për shpërndarjen e fondeve të 20 përqindëshit për punëtorët e kualifikueshëm të këtyre ndërmarrjeve shoqërore. Shuma e fondeve që është në procedurë të shpërndarjes kësaj radhe është 1,119,119.68

euro (një milion e njëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e njëqind e nëntëmbëdhjetë euro e 68 cent). Nga kjo shpërndarje do të përfitojnë rreth 1.499 punëtorë të këtyre ndërmarrjeve shoqërore që i kanë plotësuar kriteret ligjore për të qenë pjesë në shpërndarjen e 20 përqindëshit. "Bartja e këtyre fondeve do të



bëhet në llogarinë e Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të

Kosovës (BSPK) në pajtim me nenin 10.5 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13 (me ndryshime). Agjencia deri më tani ka shpërndarë afër 122 milionë euro për 20 përqind dhe nga këto shpërndarje kanë përfituar rreth 47.000 (katër dhjetë e shtatë mijë) punëtorë dhe ish-punëtorë të ndërmarrjeve shoqërore. Në ndërkohë,

Agjencia është në proces të përgatitjes së dokumentacionit për shpërndarjen e fondeve të 20 përqindëshit për punëtorët e kualifikueshëm edhe për disa NSh të tjera, për çka punëtorët e këtyre ndërmarrjeve dhe opinioni i gjerë publik do të informohen në një të ardhme të afërt", është thënë në njoftimin e AKP-së.

t'ua plotësojë të drejtat e tyre



sit e Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës, të kryesuar nga kryetari, Avni Hajdini. Haradinaj u zotua se Qeveria e Kosovës do të jetë partnere e

BSPK-së për përmbushjen e kërkesave të BSPK-së. "Në mbledhjen e parë të Qeverisë do të ngrihen shqetësimet e shprehura nga ana juaj. Nuk do

të rrimë në pritje dhe do të ndërmarrim veprime konkrete për realizimin e kërkesave për të drejtat e punëtorëve në vend", ka thënë Haradinaj.

KDI-ja ka trajtuar më shumë se 50 raste nga të drejtat e punës

Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka vlerësuar se diskriminimi në konkurse, mospagesa e pagës dhe kontributeve pensionale, largimet nga puna pa arsye, degradimet në vendin e punës, mungesa e efikasitetit në gjykimin e çështjeve që lidhen me punëtorë, konkursi publik si mundësi për punësim partiak etj., janë problemet që shqetësojnë të gjithë qytetarët e aftë për punë. "Pavarësisht se Ligji i Punës apo Ligji për Shërbyesit Civilë ka paraparë kriteret se si dhe kur mund të bëhet largimi nga puna, ulja në pozitë, suspendimi, apo edhe pranimi në punë, shpesh punëdhënësit, të sektorit privat apo atij publik, nuk i respektojnë ligjet përkatëse. Vonesa e gjykatave për zgjidhjen dhe trajtimin e çështjeve të natyrave të ndryshme ka bërë që të vonohen edhe çështjet e punëtorëve që kërkojnë realizimin e të drejtave të tyre", është thënë në komunikatën e KDI-së.

Instituti Demokratik i Kosovës si pjesë e Transparency International ka bërë me dije se gjatë gjithë kohës ka pranuar ankesa nga shumë qytetarë rreth shkeljeve të të drejtave të punës

nga administrata shtetërore apo edhe ndërmarrjet private. "Deri më sot janë pranuar dhe trajtuar më shumë se 50 raste nga të drejtat e punës. Përveç kësaj, KDI-ja në fillim të këtij viti ka kryer një hulumtim me shërbyesit civilë të punësuar në institucionet e sistemit gjyqësor, prokurorial dhe atyre të sundimit të ligjit (gjykatat, prokuroritë, policia, shërbimi korrektues etj.), i cili dëshmon se më shumë se gjysma e pjesëmarrësve mendojnë se sektori i sundimit të ligjit vazhdon të mbetet jofunksional, kurse procedurat e punësimit dhe gradimit tejet të politizuara. Edhe më shqetësues është fakti se shërbyesit civilë kanë shumë pak njohuri rreth mekanizmeve në të cilat ata duhet t'i raportojnë rastet e tilla, dëshmon hulumtimi", është thënë në këtë komunikatë.

KDI-ja kërkon nga institucionet publike t'i respektojnë të drejtat në konkursin publik dhe të drejtat që dalin nga kontratat e punës. Po ashtu, KDI-ja i bënë thirrje prokurorisë të hetojë sa më shumë raste të punësimeve pa merita dhe në kundërshtim me parimet e barabartësisë së palëve.

Forumi i ardhshëm i biznesit do të mbahet në Arabinë Saudite

PRISHTINË, 1 MAJ (ER) - Nën përkujdesjen e zëvendëskryeministrit të Kosovës, Enver Hoxhaj, dhe në bashkëpunim me Odën Ekonomike të Kosovës dhe Klubin e Prodhuesve të Kosovës, është mbajtur në Prishtinë forumi i biznesit në mes të Kosovës dhe Arabisë Saudite. Në këtë forum, në të cilin kanë marrë pjesë numër i madh i përfaqësuesve të bizneseve nga Kosova dhe rreth 20 përfaqësues të bizneseve saudite, u diskutua për klimën e investimeve në Kosovë, për praktikën e mira dhe mundësitë e thellimit të bashkëpunimit ekonomik në mes të Kosovës dhe Arabisë Saudite. Mysafirëve iu drejtua zëvendëskryeministri i Kosovës, Enver Hoxhaj, Khalid Abdulrahman AL Othman - presidenti i Saudi Mubadara Development Company, Astrit

Panxha nga Klubi i Prodhuesve, si dhe Berat Rukiqi nga Oda Ekonomike e Kosovës.

Në anën tjetër, ministri Bedri Hamza, Valdrin Lluka, si dhe drejtori i KIESA-s kanë folur për përparësitë e të bërit biznes në Kosovë, për ligjin e ri për investime strategjike dhe për politikën fiskale të favorshme.

Pas diskutimeve në konferencë, përfaqësuesit e bizneseve nga Kosova dhe Arabia Saudite kanë pasur mundësinë të mbajnë takime të ndara me njëra tjetrën, ku kanë diskutuar plane dhe ide konkrete të bashkëpunimit në fusha të ndryshme ekonomike. Zëvendëskryeministri Hoxhaj ka thënë se bizneset arabe janë të interesuara të investojnë në Kosovë, duke përmendur fusha si industria e ushqimit, bujqësia, prodhimi dhe menaxhimi i mbeturinave dhe shumë fusha të tjera. "Është një rast



jashtëzakonisht i mirë që bizneset kosovare t'i vënë kontaktet dhe të bashkëpunojnë me bizneset e Arabisë Saudite, në pro-

jekte konkrete, të cilat do të ndikojnë në shtimin e vendeve të punës dhe zhvillimin ekonomik të vendit tonë", ka

thënë Hoxhaj. Palët janë pajtuar se së shpejti një forum i tillë do të mbahet edhe në Arabinë Saudite.

NJË SHEKULL DËSHPËRIM: PAQJA E PAPËRFUNDUAR NË BALLKAN

Përvjetori që po afrohet, i fundit të Luftës së Parë Botërore, është një kujtesë se vendi ku filloi konflikti - Ballkani Perëndimor, ende nuk ka arritur një paqe të qëndrueshme. Tre proceset e mëdha politike, ligjore dhe financiare, pritet të vazhdojnë edhe gjatë: pajtimi i armiqve të mëparshëm, zgjidhja e reparacioneve të luftës dhe ndarja e pasurive të ish-Jugosllavisë midis shteteve pasardhëse të saj. Nuk ka gjasa që ndonjë nga këto tri procese të përfundojë në dekadën e ardhshme.



Prof. dr. Blerim REKA

Pothuajse njëqind vjet pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore, Ballkani Perëndimor e gjen veten duke u përballur me një zgjidhje tjetër të paqëndrueshme të paqes. Rajoni më i trazuar i Evropës është i mbërthyer në një tranzicion jo të plotë: nga luftërat pas rënies së ish-Jugosllavisë në demokracitë funksionale. Nuk ka pasur pajtim të vërtetë, as marrëveshje për reparacionet e luftës dhe asnjë shpërndarje të barabartë të aseteve jugosllave në shtetet pasuese. Këto procese mund të marrin edhe dy dekada nëse do të ketë fare.

Pajtimi i vërtetë është ende në fazën e tij fillestare. Bashkimi Evropian, nëpërmjet Procesit të Stabilizim Asociimit të nisur në vitin 1999, u përpoq t'i tërheqë ish-armiqët e kohës së luftës në një kornizë rajonale për t'u përgatitur për anëtarësim të mundshëm. Mirëpo, me miratimin e Strategjisë së BE-së për Ballkanin Perëndimor, në shkurt të vitit 2018, Komisioni Evropian bëri të qartë se nuk do të ketë aderim të anëtarëve të rinj pa zgjidhjen e kontesteve të tyre reciproke.

Dy sfidat më të vështira gjatë viteve të ardhshme do të jenë: zgjidhja e mosmarrëveshjeve Serbi-Kosovë dhe atyre Serbi -

Kroaci. E para ende ndërmjetsohet nën "Dialogun e Brukselit" (të lehtësuar nga BE-ja), por nuk mund të pritet ndonjë përparim i shpejtë (qoftë nëpërmjet njohjes reciproke të kufijve ose shkëmbimit territorial). Rasti Kroaci - Serbi është i ndryshëm, pasi që të dy vendet kanë njohur njëri-tjetrin dhe kanë marrëdhënie diplomatike. Megjithatë, ndërtimi i një marrëdhënieje "normale" mes dy fqinjëve mund të marrë të paktën një dekadë tjetër, sidomos pas acarimit të fundit të marrëdhënieve të tyre. Arritja e marrëveshjeve për reparacionet e luftës midis armiqve të mëparshëm dhe tani kandidatëve për anëtarësim në BE, është ende në pritje. Përveç disa rasteve individuale në Gjykatën Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë (ICTY), as nuk janë iniciuar ndjekje penale për gjenocid, e as nuk janë bërë vlerësime të besueshme për dëmet e luftës bazuar në një vlerësim neutral dhe të pavarur. Ndarja e aseteve shtetërore të ish-Jugosllavisë ka kaluar edhe për 15 vjet pa ndonjë rezultat të qartë. Pjesa më e madhe e kësaj pasurie tani i takon Serbisë, një situatë që është kontestuar nga ish-njësitë e tjera konstituuese federale, të cilët kërkojnë një shpërndarje më të barabartë.

As luftë, as demokraci

Pritet që Ballkani Perëndimor të mbetet nën një monitorim të fuqishëm nga komuniteti ndërkombëtar gjatë dekadës së ardhshme. Kjo marrëveshje ka

për qëllim ta ruajë paqen, por nuk ka të ngjarë t'i eliminojë disa nga burimet kryesore të tensionit. Gjithnjë e më shumë, këto mund të gjenden në demokracitë e reja të rajonit, dështimet e të cilave mund ta mbajnë rajonin si një zonë krizash në të ardhmen.

Pas Luftës së Parë Botërore teoricienët liberalë u përpoqën ta shpjegojnë lidhshmërinë e përgjegjësive për luftën me regjimet jodemokratike në periudhën para luftës. Megjithatë, çereku i shekullit të kaluar në Ballkan tregon se demokracia jo domosdoshmërisht sjell paqen. Në vend të kësaj, konflikti i armatosur në rajon qe shmangur nga një kombinim i mbikëqyrjes ndërkombëtare, programeve rajonale për zhvillim ekonomik dhe udhëheqjet e rrënjësura politike që sigurojnë stabilitet, ndonëse me korrupsion të lejuar dhe lulëzim të strukturave mafioze. Deri në njohjen dhe trajtimin e problemit të fundit, Ballkani Perëndimor do ta ketë të vështirë të arrijë një paqe të qëndrueshme përmes një qeverisjeje demokratike.

Duket se rajoni ende nuk i ka mësuar mësimet historike pas Luftës së Parë Botërore. Ideologjia e tij mbizotëruese post-komuniste mbetet nacionalizmi, shpesh në variantin e korruptuar, klient-shtet. Si opium për masat, "idetë e mëdha kombëtare" i ushqejnë qytetarëve, të cilët paralajmërohen kundër armiqve tradicionalë kombëtarë. Duke iu shmangur kësaj votuesve, politikanët e korruptuar vazhdojnë t'i harxhojnë buxhetet kombëtare të pasqerësuar. Mendimi nationalist nuk ka zgjidhur asnjë çështje të vetme politike në Ballkan, por ka qenë shumë i mirë për fryrjen e llogarive bankare të politikanëve. Modeli i Ballkanit i pasluftës është treguar i efektshëm për ruajtjen e paqes së pasigurt, por nuk ka zgjidhur problemet themelore strukturore të pasluftës. Kjo është një strategji klasike afatshkurtër. Duke toleruar sundimin e bosëve politikë lokalë që manipulojnë

agjendën nacionaliste për të qëndruar në pushtet, një model i tillë qeverisës do ta mbajë të brishtë paqen rajonale. Këto animozitete të zymta mund të paraqiten gjatë dekadës së ardhshme në një betejë të çdo kombi vet për vete.

Gjendja e tensioneve të përherëshme bilaterale dhe rajonale të inkurajuar nga udhëheqësit e Ballkanit ushqen jo vetëm krimin e brendshëm, por edhe atë ndërkombëtar, duke përfshirë këtu edhe kontrabandën trans-nacionale të emigrantëve. Përplasja e interesave oligarkike mund të çojë në luftëra të reja tregtare në rajon. Vendet e Ballkanit Perëndimor janë pjesë e Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA), por anëtarësimi nuk ka përfunduar. Shembujt e fundit të mosmarrëveshjes dypalëshe të tregtisë dhe doganave përfshijnë "luftën për patate" midis Shqipërisë dhe Kosovës dhe përkallëzimin e fundit të një "luftime me miell" midis Serbisë dhe Maqedonisë.

Versaja dhe Dejtoni

Ish-Jugosllavia si monarki u krijua me Traktatin e Versajës (1919), kurse përfundoi me një traktat tjetër paqësor, Marrëveshjen e Dejtonit (1995). Kjo e fundit solli përfundimin simbolik të luftërave evropiane në shekullin e 20, të cilat filluan dhe përfunduan në Ballkan. Kryeqyteti i Bosnjës, Sarajeva, nxiti shkëndijën që shkaktoi Luftën e Parë Botërore dhe i njëjti qytet furnizoi casus belli për konfliktin më të rrezikshëm të armatosur të Evropës pas Luftës së Dytë Botërore.

Lufta e Parë Botërore solli në Evropë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, si një fuqi e madhe, me Presidentin Woodrow Wilson paqebërës global. Luftërat ballkanike detyruan Shtetet e Bashkuara nën presidentin Bill Clinton për të ndërhynte si ndërmjetës, pasi Evropa nuk arriti ta ndalonte masakrën ballkanike. Të dy traktatet u nënshkruan në Paris, por vetëm pas angazhimit aktiv dhe

serioz amerikan.

Nga tre krijuesit e Jugosllavisë së Versajës, Kroacia dhe Sllovenia adoptuan orientim të qartë gjeostrategjik perëndimor. Serbia, nga ana tjetër, mbetet aleatja më e fortë e Ruisë në rajon dhe ende është jashtë BE-së dhe NATO-s. Në mars, Parlamenti i Serbisë filloi ratifikimin e një marrëveshjeje të përbashkët të sigurisë me Rusinë, e cila ofron bashkëpunim më të ngushtë për sigurinë e brendshme dhe kibernetike.

Mbyllje rrugësh

Një shekull pas Versajës është e habitshme sa pak ndryshoi mentaliteti politik i Ballkanit Perëndimor. Nacionalizmi ende është forca lëvizëse, edhe pse popujt e rajonit kanë rënë viktimë e disa prej fatkeqësive më të përgjakshme të saj.

Ky frymëzim luftime tenton t'i ndalë përpjekjet e pajtimit para se të fillojnë. Por, për të punuar për pajtimin, çështja e reparacioneve duhet së pari të adresohet. Paga për dëmet e luftës është një çështje e mprehtë kudo: Gjermanisë dhe Luksemburgut iu deshën 45 vjet për të arritur një marrëveshje dhe anëtarët e koalicionit qeverisës të Polonisë vetëm kohë e fundit sugjeruan që vendi i tyre të mund ta rihapte çështjen e reparacioneve. Kroacia, Kosova dhe Bosnjë e Hercegovina kanë kërkuar që Serbia duhet të paguajë duke rritur mundësinë e disa marrëveshjeve dypalëshe ose ndoshta një të vetme dhe shumëpalëshe mbi këtë çështje midis shteteve pasardhëse të Jugosllavisë.

"Procesi i Berlinit", i iniciuar nga kancelarja gjermane Angela Merkel në vitin 2014, përpiqet ta përdorë bashkëpunimin rajonal dhe investimet në infrastrukturë si mënyrë për t'i ndihmuar vendet e Ballkanit ta shmangin përsëritjen e historisë së tyre tragjike. Raundi i pestë i këtij procesi do të zhvillohet në Londër këtë korrik, pasi katër raundet e mëparshme dhanë

rezultate premtuese, kryesisht simbolike. Në një përpjekje për ta thyer bllokadën, BE-ja ka paralajmëruar se nuk do të "importojë" ndonjë mosmarrëveshje të pazgjidhur territoriale që duhet të merret me to, si Qiproja, apo mosmarrëveshjet kufitare ndërmjet Bullgarisë dhe Rumanisë, Sllovenisë dhe Kroacisë.

Që pajtimi të shënojë progres në dekadën e ardhshme, duhet prani më e madhe amerikane në rajon. I dërguari i presidentit Trump për Ballkanin, Wes Mitchell, shpalosi muajin e kaluar, gjatë vizitës së tij më të fundit në rajon, interesin e përtërirë të Uashingtonit për Ballkanin.

Një arsye për angazhimin e ShBA-së është të kuptuarit me vonesë se sa thellë Rusia ka depërtuar në rajon. Z. Mitchell diskutoi propozimet amerikane për një zgjidhje të qëndrueshme paqësore me krerët politikë në Serbi dhe Kosovë. Mirëpo, ideja se Serbia nuk duhet ta kundërshtojë anëtarësimin e Kosovës në Kombet e Bashkuara në këmbim të anëtarësimit të saj të mundshëm në BE u kritikua menjëherë nga Ministria e Jashtme e Rusisë.

Rregullimi i kufijve dhe mbyllja e kontesteve kufitare bilaterale mbetet në agjendë, duke përfshirë edhe spekulimet rreth këmbimeve territoriale midis Serbisë dhe Kosovës.

Ndërkohë, Serbia vazhdon ta furnizojë me armë Republikën Srpska, komponenti autonom serb i Bosnjë e Hercegovinës dhe përqendroi disa herë provokativisht njësitë e blinduara në kufirin me Kosovën. Në mars, pati një shkelje të kufirit në Kosovën Verilindore ku u përfshin xhandarët serbë. Gjenerali Curtis Scaparrotti, komandanti suprem i Forcave Aleate të Forcave të NATO-s në Evropë, ka paralajmëruar se Rusia po përdor të dy shtetet serbe për ta zgjeruar ndikimin në Ballkanin Perëndimor dhe për ta parandaluar integrimin e tyre euroatlantik. I pyetur në Senatin amerikan në seancën dëgjimore se cili aspekt i ndërhyrjes ruse shkaktoi shqetësimin më të madh në Ballkan, gjenerali Scapartiti u përgjigj me një fjalë: "Serbia". Serbia mbetet fuqia më e fortë ushtarake në rajon, kurse Shqipëria e dyta. Kosova nuk ka ushtri, por mund të detyrohet ta krijojë atë brenda viteve në

vijim. Është e qartë se paqja në rajon do të varet, para së gjithash, nga Shqipëria dhe Serbia duke i tejkaluar dallimet e tyre, gjë që duket e pamundur pa një prani më të fortë amerikane. Pritet që presioni diplomatik më i fuqishëm i ShBA-së të bëhet në Ballkanin Perëndimor në vitet e ardhshme. ShBA-ja ka të ngjarë ta krijojë bazën ushtarake në një nga vendet anëtare të NATO-s në rajon, me gjasë në Shqipëri

Dy skenarët

Skenari më i mundshëm gjatë dekadës së ardhshme është që BE-ja dhe ShBA-ja të vazhdojnë ta ndjekin qasjen e tyre të bazuar në stabilitet, duke i dhënë prioritet sigurisë rajonale, për ta bllokuar depërtimin e mëtejshëm të Rusisë. Fokusi kryesor do të jetë tërheqja e të gjitha shteteve të rajonit nën ombrellën euroatlantike. Kjo shihet se sa e rëndësishme është, pas paralajmërimit të fundit, nga ministri i Jashtëm rus Sergei Lavrov, i cili tha se, duke detyruar Beogradin, të zgjedhë midis Rusisë dhe Perëndimit, politikëbërësit e BE-së dhe ShBA-së mund të

"hyjnë të njëjtën grackë si në krizën ukrainase, kur shoqëria ukrainase u nda". Presioni për ta lënë orbitën ruse vetëm sa do të shtohet kur Serbia do të hyjë në fazat përfundimtare të procesit të pranimit në BE.

Hapi i parë për Beogradin do të ishte njohja e Kosovës ose, të paktën, duke mos kundërshtuar anëtarësimin e Kosovës në OKB. Tjetri, do të jetë që Serbia ta rishikojë aleancën e saj të ngushtë me Rusinë. Aq sa qeveria serbe do të përpiqet të përafrohet me BE-në, mund të përballlet me trazira masive publike dhe, ndoshta, një kundër-reagim nga Rusia, për ta mbrojtur aleatin e saj më të fortë rajonal. Por, që nga koha kur Moska po e ndjen intervenimin ushtarak në Ukrainë dhe Siri, mund të ngurrojë të rrezikojë një aventurë të re në Ballkanin Perëndimor - veçanërisht me ShBA-në e cila tani po i mbështet aspiratat e Ukrainës për anëtarësimin në NATO.

Siç u përmend më lart, ShBA-ja mund të pritët të marrë një rol më të rëndësishëm në Ballkanin Perëndimor. Uashingtoni me siguri nuk do ta lejojë Rusinë të ndërhyjë në atë se si vendet e

Ballkanit zgjedhin shtrirjen e tyre gjeopolitike. Në ndjekjen e këtij qëllimi strategjik, ShBA-ja dhe BE-ja do t'i ndjekin rrugët paralele. Uashingtoni do të përqendrohet në ruajtjen e paqes dhe sigurisë rajonale, ndërsa Brukseli do të përqendrohet në zhvillimin ekonomik dhe ndërtimin e institucioneve demokratike.

Skenari i dytë, më pak i mundshëm, është se rajoni në fund do të kthehet në ndërtimin e shteteve demokratike pas tranzicionit të tij të gjatë pas luftës. Suksesi i plotë është i paarrtshëm në afat të shkurtër jo vetëm për shkak të problemeve strukturore të përmendura më parë, por edhe për shkak të pranisë së fortë politike, ushtarake dhe energjetike të Rusisë. Kohët e fundit, Lavrovi paralajmëroi Maqedoninë për rreziqet e anëtarësimin në NATO - dhe ky vend mbetet një pikë kritike. Duke e lënë atë jashtë aleancës perëndimore vetëm sa do t'i bashkonte rreziqet afatgjata gjeopolitike në Ballkanin Perëndimor.

(Botuar dje në GIS. Përkthet nga anglishtja: Arsim Osmani)

Trumpi dhe modeli gjerman

Nikolas BUSSE (FAZ)

Mund të ndodhë që evropianët të mos shpëtojnë dot javët e ardhshme nga një konflikt i ashpër me Qeverinë Trump, si në çështje tregtare, ashtu edhe në atë të Iranit. Disa gjëra që thotë Donald Trumpi për marrëdhëniet transatlantike janë thjesht absurde. Që NATO-ja u bën më shumë punë evropianëve se amerikanëve, siç u shpreh ai në vizitën e punës së kancelares në Uashington është, për shembull, një pohim i diskutueshëm. Aleanca perëndimore u ofron shteteve të Bashkuara prej vitesh qasje strategjike ndaj Evropës, njëri nga rajonet më të rëndësishme të politikës botërore. Po të mos ishte kështu, nga NATO-ja do të kishin hequr dorë që paraardhësit e Trumpit. Por presidenti ka të drejtë kur ua kujton tani gjermanëve se një aleancë kërkon një ndarje në njëfarë mënyrë korrekte të barrës. Merkel i pranoi këtë në Uashington. Pyetja e madhe që shtrohet është nëse qeveria federale do t'i pasojë këto fjalë me më shumë vepra se deri tani.

Trumpin shumë qytetarë dhe politikanë e përjetojnë si fyrie, në mos si rrezik për stabilitetin e botës. Këto shqetësime janë pa dyshim të justifikuar po ta shohësh stilin nationalist, impulsiv dhe të dashuruar me veten të Presidentit. Por përballë Gjermanisë, Trumpi rimerr një kritikë, të cilën e kanë shprehur



para tij edhe partnerë të tjerë të vendit tonë. Pozicioni i Gjermanisë në botë karakterizohet prej shumë vitesh nga dy zhvillime, të cilat çojnë automatikisht në konflikte me aleatët: përmbytja ushtarake dhe tepricat e mëdha në eksporte. Që në BE kjo ka çuar herë pas here në irritime, jo së

fundi në Francë. Në Evropë Gjermania është aq e fortë sa ta imponojë modelin e saj. Përballë Amerikës që vazhdon të jetë shumë e fuqishme puna bëhet më e vështirë, edhe sepse nuk ka më një interes të përbashkët sipëror si në kohët e Luftës së Ftohtë. Mund të ndodhë që evropianët

të mos shpëtojnë dot në një kohë të afërt nga një konflikt i ashpër me Qeverinë Trump, si në politikën tregtare, ashtu edhe në çështjen e Iranit. Por, pavarësisht nga kjo, është në interesin e mirëfilltë gjerman që ta bëjmë më pak të sulmueshëm modelin tonë. Një fuqi ekonomike e mesme duhet ta garantojë sa të

jetë e mundur më shumë vetë mbrojtjen e saj. Dhe kriza financiare ka treguar se investimi i kursimeve gjermane në botën e jashtme (kjo është ana tjetër e medaljes e tepricave në eksport), nuk është gjithmonë ide e mirë. Këtu janë kantieret e vërteta të ndërtimit të koalicionit.

© Reuter

OSBE-ja konfirmon përkrahjen për Gjakovën

GJAKOVË, 1 MAJ (ER) - Kryetari i Komunës së Gjakovës, Ardian Gjini, ka pritur shëfën e misionit të OSBE-së në Kosovë, Jan

Braathu, me të cilin ka diskutuar për tema të ndryshme, përfshirë zhvillimin ekonomik lokal, situatën e komuniteteve joshumicë

që jetojnë në Gjakovë. Ambasadori Braathu ka konfirmuar se misioni që ai drejton do ta japë tërë ndihmën e mund-

shme dhe të nevojshme për Komunën e Gjakovës, që kjo komunë të zhvillohet edhe më shumë në të ardhmen.



Prishtina do të bëhet me spital

PRISHTINË, 1 MAJ (ER) - Ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, gjatë një takimi me kryetarin e Prishtinës, Shpend Ahmeti, ka bërë me dije se kryeqyteti do të bëhet me spital. Ai ka thënë se ky projekt, më në fund, do të bëhet realitet dhe rezultatet e para do të shihen së shpejti. "Prishtina ka nevojë për një spital të qytetit. Projekti dhe realizimi i tij ka vite që është zvarritur duke lënë prishtinasit pa shërbime të merituar shëndetësore. Kur kam ardhur

në krye të Ministrisë së Shëndetësisë, një nga prioritetet e mia ka qenë ndërtimi i këtij spitali", ka thënë Ismaili, duke bërë me dije se parakushtet duhet të jetë lokacioni që projekti të nisë sa më parë. Kryetari i Prishtinës, Shpend Ahmeti, ka thënë se mirëpret bashkëpunimin me Ministrinë e Shëndetësisë për spitalin e Prishtinës. Sipas tij, tani duhet të krijohen grupet punuese në mënyrë që puna të mos vonohet.



Thellohet bashkëpunimi në mes të Kurtit e Bahtirit

MITROVICË, 1 MAJ (ER) - Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka qëndruar në Mitrovicë, ku është takuar me kryetarin e kësaj komune, Agim Bahtiri, me të cilin ka biseduar për zhvillimet politike në vend dhe për qeverisjen në këtë komunë. Në këtë takim është biseduar më shumë rreth funksionimit të koalicionit për qeverisjen lokale në Mitrovicë midis AKR-

së e Vetëvendosjes si dhe për bashkëpunimin ndërmjet këtyre dy subjekteve politike. Të dy bashkëbiseduesit kanë vlerësuar se bashkëpunimi i deritashëm midis AKR-së e Vetëvendosjes për qeverisjen e Mitrovicës është në nivel, por që gjithnjë ka mundësi që ky bashkëpunim të thellohet për të mirën e qytetarëve të Mitrovicës dhe të vendit në përgjithësi.

Sot fillon aksioni për heqjen e mbeturinave në Rahovec

RAHOVEC, 1 MAJ (ER) - Sot (e mërkurë) do të fillojë aksioni për heqjen e të gjitha "pikave të zeza" me mbeturina në tërë hapësirën e Komunës së Rahovecit. Kryetari i kësaj komune, Smajl Latifi, u ka bërë thirrje qytetarëve të kësaj komune, subjekteve afariste, organizatave joqeveritare, institucioneve arsimore, individëve dhe të gjithë atyre që e duan një

ambient më të pastër në territorin e Komunës së Rahovecit, që të bashkohen në aksionin gjithëpërfshirës për heqjen e mbeturinave të ngurta dhe të amvisërisë. "Tashmë janë marrë të gjitha masat e nevojshme dhe është hartuar plani i veprimit për mbarëvajtjen e këtij aksioni të dobishëm për të gjithë. Komuna e Rahovecit synon që në një afat sa më të shkurtër kohor të

shndërrohet në zonë atraktive të turizmit rural e kulturor, prandaj kërkohet që secili ta përmbushë pjesën e vet të përgjegjësisë", ka thënë Latifi, duke kërkuar nga qytetarët e Komunës së Rahovecit që ta mbështesin këtë aksion dobiprurës për të gjithë. Aksioni simbolikisht do të fillojë të mërkurën në orën 8:30 nga vendi i quajtur "Rrasat e Rahovecit".



Vazhdojnë investimet në infrastrukturën rrugore në Obiliq

Obiliq, 1 maj (ER) - Ka përfunduar asfaltimi i dy rrugëve në Komunën e Obiliqit, rrugës "Nora Kelmendi" në fshatin

Siboc dhe rrugës "Minatori" në fshatin Hade. Kryetari i komunës, Xhafer Gashi, së bashku me

nënkryetarin Ajat Berisha dhe drejtorin e Drejtorisë së Infrastrukturës Lokale, Enver Grajqevci, kanë parë nga afër

realizimin e punimeve. Ky projekt është financuar nga KEK-u, me kërkesë të Komunës së Obiliqit.



Sami Frashëri, iluminist mbrojtës i diturisë dhe i shkencës



Shkruan: Jahja LLUKA

Samiu e Naimi në një letër dërguar një mikut të tyre për arritjet në shkrimin e në lëvrimin e gjuhës shqipe: "Armiqtë e kombit tonë, thoshin ata, donin të na gënjenin që prej kohe se gjoja gjuha shqipe është një gjuhë e prishur dhe trashamane, se nuk mund të shkruhet, se s'ka gramatikë, se me të nuk mësohen shkencat e tjera. Por në fund panë se shqipja u bë, u shkrua, u krijua alfabeti i saj, u hartua gramatika, u shtypën librat e shkencës, u përkthyen poezi të bukura prej çdo gjuhe të huaj. Me një fjalë u kuptua se ç'gjuhë e përsosur dhe e rregullt është shqipja".

"Sendet më të shtrenjtë në botë, shkruante Samiu, janë nderi dhe atdheu. Ata që për dobi personale shkelin dashurinë e atdheut, ata shkelin njëkohësisht edhe nderin e tyre".

Ishte 1 qershor i vitit 1850 kur erdhi në këtë botë Samiu, një fshat i vogël në Shqipëri "Frashëri", vendlindja e tij.

Fëmijëria e Samiut nuk kishte qenë fare e lehtë, fati i tij i trishtë ishte që mbeti herët pa prindërit duke i lënë jetim tetë fëmijë, dy vajza dhe gjashtë djem.

Vëllai i madh Abdyl i ishte ai që u desh të përkujdesej për më të vegjlit fëmijë. Janina në atë kohë ishte kryeqytet i vilajetit dhe si e tillë ofronte mundësi më të mira

jetese. Kushtet e vështira ekonomike dhe kërkesat e fëmijëve bënë që Abdyl të largohet për në Janinë.

Kështu, Samiut iu dha një mundësi e mirë për të studiuar ku regjistrohesh në gjimnazin Zosimea, për shkak që tregoi aftësi të jashtëzakonshme në shumë disiplina si matematikë, anatomi, gjeografi, kozmografi dhe histori të natyrës u diplomua para kohe.

Si një mendje gjeniale që ishte Samiu mësoi frëngjisht, italisht, persisht, arabisht, latinisht si dhe greqishten e re dhe të vjetrën.

Puna e tij krijuese me gjithë këto njohuri që posedonte rrjedhë për tri dekada pa u ndalë duke nxjerrë më të mirën nga vetja në dobishmëri të kombit dhe kulturës.

Në Stamboll botoi romanin e tij të parë, atëherë kur Samiu ishte

vetëm 22 vjeç. Krijimtaria e tij njëhë më shumë se 60 vepra të botuara në gjuhën shqipe, atë perse dhe turke.

Samiut i dedikohet shkrimi i gramatikës shqipe të cilin e titullon "Shkronjëtoje e gjuhës shqip", dhe po ashtu njihet edhe si hartues i alfabetit shqiptar.

Vepra më e madhe e shkruar në gjuhën shqipe nga Sami Frashëri është "Shqipëria ç'ka qenë, ç'është dhe ç'do të bëhet"?

Me këtë vepër Samiu shtroi pikëpamjet e tij në sferën historike, diplomatike dhe politike për një shekull më pas, ngjarje të cilat do karakterizojnë objektivat e tij në libër.

Por ishte vepra KAMUS AL-LAM të cilës Samiu i kushtoi 11 vite, e që kur u botua kjo vepër nisi rrugëtimin në të gjitha bibliotekat më të mëdha të asaj kohe.

Samiu kishte një qëllim të vetëm

ngritjen e çështjes shqiptare në qarqet ndërkombëtare për tu bërë kështu njëri ndër personalitetet më të shquara të kombit shqiptar.

Shkroi shumë artikuj në gjuhë të huaja në të cilat përmendi anticitetin e popullit shqiptar sepse fakti që ishte nën zgjedhje të huaj dhe i mjeruar për shekuj e bënin Samiun që ta vuante këtë tragjedi të kombit.

Luftoi obskurantizmin mesjetar të monarkisë absolute dhe ishte në kundërshtim me praktikën dhe ligjet e Perandorisë Osmane të cilat sipas tij kishin ngulfatur qytetërimin. Samiu ishte desit dhe sipas tij bota nuk mund të ishte ashtu siç e shpjegonin librat fetar sepse Samiu theksonte se gjithë trupat qiellorë u shtrohen një ligji dhe një rregulli.

Pikëpamjet e Samiut u vlerësuan lart në kohën kur jetoi, sepse ai

këmbëngulte që vetëm nëpërmjet dijes arrihen majat e qytetërimin.


Sipas tij kombi shqiptar edhe pse i vogël kishte dhënë shumë për kulturën botërore, thesarin më të çmuar e sillte përparimi, progresi njerëzor që do ta linte pas errësirën e krijuar prej shekujsh.

E kjo ishte faktike sepse edhe pse populli shqiptar kishte dhënë shumë asses nuk rimëkëmbej nga zgjedha e huaj.

Idetë e revolucionit francez kishin nxitur mendimin kritik dhe revolucionar të Samiut, veprat e Volterit, Dideros, Zhan Zhak Rusoit kishin lënë gjurmë të pashlyeshme në historinë botërore e që Samiu i admironte tej mase. Samiu theksonte vazhdimisht se Perandoria Osmane kishte mbajtur pezull civilizimin ku filloi antikiteti e që sipas tij duhej medoemos krijimi i një Shqipërie të re duke lënë anash prapambeturin që e rrethonte dhe po ashtu krijimi i një Turqie të re me frymë evropiane.

Ishte kundër çdo ndasie fetare të cilat nga armiqtë e kombit stimuloheshin duke humbur identitetin dhe duke u tjetërsuar në kombësi tjetër për shkak të fesë. Samiu luftoi aq shumë problematikat të cilat vinin direkt nga manipulimi përmes fesë e që ishin çdoherë në dëm të kombit shqiptar. "Shqiptari është shqiptar para se të jetë mysliman apo i krishterë", shpallte ai, duke ngritur kështu idenë e kombësisë mbi idenë e fesë.

Mbylli sytë në Stamboll më 18 qershor 1904, për ta lënë pas veprën e tij shumë të madhe e cila i dha namini për të mbetur një ndër personalitetet më të mëdha shqiptare dhe jo vetëm.



Shtyhet greva e paralajmëruar e aktorëve

PRISHTINË, 1 MAJ - Trupa rezidente e Teatrit Kombëtar të Kosovës (TKK) kishte paralajmëruar se prej ditës së parë të muajit maj do t'i rikthehet grevës dhe do të bëjë bllokim total të këtij institucioni. Mirëpo greva e cila ishte paralajmëruar për të martën është shtyrë përsëri, kanë bërë me dije aktorët e TKK-së. "Tashmë u bënë disa muaj prej kur Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), së bashku me një grup punues, vazhdimisht janë takuar dhe kanë punuar që të arrihet realizimi i kërkesave të aktorëve. Diçka është punuar dhe ka lëvizur, por asgjë nuk ka diçka konkrete, prandaj ne shqyrtuam mundësinë e rikthimit në

grevë pasi u bënë shumë muaj pritje. Tani na është kërkuar edhe një javë kohë pasi ministri i Kulturës qenka jashtë vendit deri këtë të premte. Ne sigurisht se nuk duam të bëhemi arrogantë dhe ashtu siç kemi pritur këta muaj do të presim edhe një javë. Vazhdojmë të jemi optimistë dhe ende duam të besojmë në gatishmërinë pozitive të ministrit Gashi", është thënë në njoftimin e aktorëve të TKK-së dërguar redaksisë së "KultPlus"-it.

Pas një marrëveshje me ministrin e MKRS-së, Kujtim Gashin, aktorët e patën pezulluar grevën pasi që patën marrë premtim nga ai për rritje të pagave.



E rrallë

Derrkucja Peppa bllokohet nga platforma kineze

Derrkucja Peppa, një film i animuar britanik, është hequr nga një prej platformave më të njohura të medias sociale të Kinës, ku mediet shtetërore thonë se karakteri përdoret në mënyrë shkatërruese. Përdoruesit e medieve sociale në vend kanë vërejtur të shtunën se



janë hequr disa video të filmit. Karikatūra e Peppa Pigut është jashtëzakonisht popullore në Kinë dhe ndiqej më tepër nga fëmijët.

FOTO E DITES



Punëtorët shkarkojnë shalqinj të nga një varkë në lumin Buriganga në Bangladesh. /AFP/

E jashtëzakonshme

Tatuazhi në gjoks i ndryshon jetën gruas me kancer

Një grua humbi gjoksin pasi u diagnostikua me sëmundjen e kancerit. Linda Bright ka pohuar se e urrente shenjat në trupin e saj pas trajtimeve për kancerin e gjirit. Por 69-vjeçarja nga Felixstowe në Suffolk vendosi që shenjën e saj ta mbulojë me tatuazh. Ajo thotë se tatuazhi në gjoks i ndryshoi jetën pasi besimi i saj u përmirësua aq shumë sa tani është e lumtur të shëtisë në rrugë.



BARSOLETA E DITËS



Profesoresha:
- Qysh po i ngucni vajzat e klasës, kur këto i keni si motra.
Nxënësi:
- Po çfarë motra, oj profesoreshë! M'i pas motra e kishim pas mbiemrin e njëjtë.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetëm gjatë vikendit në ora 14:30

“BLACK PANTHER” 3D (PG-13)

Aksion/Aventurë/Fantastiko-Shkencor; 2 orë 15 min

Rolet: Chadwick Boseman, Angela Basset, Michael B. Jordan, Lupita Nyong'o, Martin Freeman, Forest Whitaker, Andy Serkis, etj.
Regjia: Ryan Coogler



Në ora 17:00

“PETER RABBIT”

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 33 min

Rolet: James Corden, Rose Byrne, Domhnall Gleeson, Sam Neill, Daisy Ridley, Elizabeth Debicki, Margot Robbie, etj.
Regjia: Will Gluck



Në ora 19:00

“PACIFIC RIM UPRISING” (PG-13)

Aksion/Aventurë/Fantastiko-Shkencor; 1 orë 51 min

Rolet: John Boyega, Scott Eastwood, Jing Tian, Cailee Spaeny, Rinko Kikuchi, Burn Gorman, Adria Arjona, Charlie Day, etj.
Regjia: Steven S. DeKnight



Në ora 21:00

“RED SPARROW” (R)

Mister/Triller; 2 orë 25 min

Rolet: Jenifer Lawrence, Joel Edgerton, Matthias Shoenearts, Jeremy Irons, Mary-Louise Parker, Charlotte Rampling, etj.
Regjia: Francis Lawrence



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.



DASHI
Sot jeni shumë diplomat në sjellje

dhe askush nuk do t'i kuptojë qëllimet reale që keni karshi situatave të caktuara.



DEMI
Fokusi sot është puna për ju dhe duhet të

justifikoni në familje një vonesë tej normave në punë, që ju ka bërë t'i anashkaloni detyrimet tuaja.



BINJAKËT
Edhe pse sot duket se po mendoni për

ndjenjat dhe emocionet e brendshme, arsyeja do t'ju bëjë që të hiqni dorë shpejt nga ëndërrimet tuaja.



GAFORRJA
Po merreni me detaje komplet të

parëndësishme kur në fakt gjërat prioritare për ju i keni lënë pas dore.



LUANI
Po ndodhin shumë gjëra që

nuk po arrini t'i menaxhoni. Bëni mirë ta kërkonti ndihmën e një personi tjetër, megjithëse nuk ju pëlqen.



VIrgjëresha
Jeni në udhëkryq sa iu përket

ndjenjave. Nuk po vendosni dot ndërmjet një personi të kaluar që është rishfaqur dhe një dashurie të re.



PESHORJA
Humorin tuaj të keq sot mund ta durojnë

vetëm miqtë e ngushtë dhe personat e afërt. Do të keni probleme në ambientin e punës.



AKREPI
Ndërmjet asaj që dëshironi dhe asaj që

keni realisht ka një diferencë shumë të madhe, por ju nuk po e vini re.



SHIGJETARI
Jeni të rrethuar me

njerëz që mendojnë po njësoj si ju për tema të ndryshme. Kjo gjë do t'ju bëjë ditën edhe më të këndshme.



BRICJAPI
Asnjë nuk mund t'ia lejojë vetes t'ju

urdhërojë sot. Do t'i tregoni që jeni ju padronët e vetes suaj dhe asaj që doni të realizoni.



UJORI
Vetëm ose në çift ju nuk do të


ndiheni në asnjë moment të lënë pas dore. Jeni aq vital sa përçoni dhe thithni veç energji pozitive.



PESHQIT
Konkurrenca do t'ju bëjë me

ambicioz sot. Do të arrini të përfundoni projekte që kishin kohë të lëna pas dore.

Vazhdojnë xhirimet për filmin e ri të Will Smithit



Aktori 49-vjeçar është fotografuar teksa po filmonte scena të reja aksion për filmin e ri "Gemini Man" në Cartagena de Indias në Kolumbi.

Muajin e kaluar Will është parë duke xhiruar bashkë me Mary Elizabeth Winstead në Gjeorgji. Filmi i ri do të dalë në kinema në vitin 2019.

Calvin Harrisi merr një titull gjigant



DJ Calvin Harris është emëruar si artisti scokez më i dëgjuar i shekullit 21. Fituesi i çmimit Grammy mori vendin e parë pas shumë hiteve botërore gjatë 12 vjetëve të fundit. "Është një nder

shumë i madh që të marrë këtë titull si artisti scokez më i dëgjuar i shekullit 21", ka thënë Harrisi. Projektet e artisti u dëgjuan më së shumti në radio dhe televizion në Mbretërinë e Bashkuar.



Princi në dietë për Meghanin

Përpara se ta njihje Meghanin, dieta e princit Harry ishte ajo e një djaloshi tipik beqar. Shpeshherë jashtë pallatit Kensington është parë edhe me hamburger në dorë apo në picerinë e preferuar "Bunga Bunga" apo në restorantin "Rum Kitchen" në

Noting Hill. Pjesë e pandarë e tij ishin fast food-et, madje miq të shkollës thonë se ai jetonte për mishin e pjekur të pulës apo McDonaldsit. Por, së fundmi, falë Meghanit, princi ka arritur të humbasë ndjeshëm kilogramë dhe të shfaqet më elegant.

Avicii u vetëvra me shishen e thyer



Avicii bëri vetëvrasje me shishen e thyer të verës, të cilën e përdori për ta prerë veten, ka shkruar "TMZ". Burime të afërta me rrethanat e vdekjes së Dj-it

të famshëm, deklarojnë se ai me të vërtetë ia mori jetën vetes. Bëhet me dije se metoda e vdekjes ishte me copën e qelqit që e shkaktoi gjakderdhjen masive.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT PILKINGTON
Envert
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE	ROMA - LIVERPOOL	1	HAMPTON AND RICH. - TRURO CITY	3+	FREDERICIA - ROSKILDE	1
-------------------	------------------	---	--------------------------------	----	-----------------------	---

Drita kërkon fitoren e titullit kundër Gjilanit

Skuadra e Dritës kundër Gjilanit synon fitoren që e dërgon edhe më afër titullit të kampiones. "Derbi kundër Gjilanit ka ardhur në kohën më të mirë, kur ne si skuadër jemi duke kaluar nëpër një formë të jashtëzakonshme, për të cilën dëshmojnë rezultatet e arritura. Mungesa për këtë ndeshje nuk do të kemi, kurse presim që derbi të jetë i zjarrtë sikurse në të kaluarën, kurse fituese do të dalë Drita", ka thënë Bujar Shabani

EPOKA E RE **Veton ZYMBERI**

Prishtinë, 1 maj - Derbi më i madh në futbollin e Kosovës në mes të Gjilanit dhe Dritës zhvillohet sot (e mërkurë) nga ora 16:00. Drita që luan në këtë ndeshje në cilësinë e skuadrës mysafire kundër rivalëve lokalë, kërkon fitore në mënyrë që t'i ofrohet edhe më shumë titullit të kampiones në Vala Superligën e Kosovës në futboll. Bujar Shabani ka thënë të martën për "Epokën e re" se skuadra e tij është e gatshme ta fitojë ndeshjen kundër rivalëve të Gjilanit, kurse mungesa në formacionin e Bekim Isufit nuk do të ketë. "Derbi kundër Gjilanit ka ardhur në kohën më të mirë, kur ne si skuadër jemi duke kaluar nëpër një formë të jashtëzakonshme, për të cilën dëshmojnë rezultatet e arritura. Mungesa



për këtë ndeshje nuk do të kemi, kurse presim që derbi të jetë i zjarrtë sikurse në të kaluarën, kurse fituese do të dalë Drita", ka thënë Shabani. Në këtë edicion Gjilani ka rezultate më të dobëta se Drita, por

për ndeshjen që zhvillohet sot synohet vetëm fitorja. "Një prej lojtarëve më të mirë të Gjilanit, Betim Haxhimusa, ka bërë me dije se presioni është në skuadrën kundërshtare dhe në këtë ndeshje synohen tri pikët.

Ne nuk kemi çfarë të kalkulojmë në këtë ndeshje dhe hymë vetëm për tri pikët e plota. E mira është se nuk do të kemi asnjë mungesë dhe presim një ndeshje të fortë dhe një atmosferë edhe në tribuna", ka

Vala SUPERLIGA

Të mërkurën takohen:
Liria-Trepça '89
Gjilani-Drita
Feronikeli-Prishtina
Llapi-Drenica

Të enjten takohen:
Vllaznia (P)-Vëllaznimi
Besa-Flamurtari

Tabela	PIKË
1. Drita	59
2. Prishtina	56
3. Liria	47
4. Llapi	45
5. Drenica	45
6. Trepça '89	44
7. Gjilani	43
8. Feronikeli	42
9. Vëllaznimi	36
10. Flamurtari	19
11. Besa	19
12. Vllaznia	14

deklaruar Haxhimusa. Drita është e para me 59 pikë, kurse Gjilani zë vendin e shtatë me 43 pikë. Krahas kësaj ndeshje, sot zhvillohet edhe derbi në Drenas, Feronikeli është nikoqir i skuadrës së Prishtinës.

Altin Zogaj të shtunën bokson kundër çekut Jano

PRISHTINË, 1 MAJ - Boksieri nga Komorani i Drenasit të Kosovës, Altin Zogaj, më 5 maj në qytetin e Numburgut do të debutojë në boksion profesionist në kategorinë gjysmë të rëndë. Kundërshtar i Zogajt do të jetë boksieri çek Bohuslav Jano, kurse ngjarjen e organizon menaxheri shqiptar Astrit Ademaj. "Jam duke u përgatitur maksimalisht me Festimin dhe trajnerët e mi, pasi synoj debutim me sukses. Ndihem i lumtur që do të debu-

toj të shtunën dhe synoj fitore. Kjo do të jetë një sfidë e rëndësishme për mua, pasi kundërshtari ka zhvilluar 28 luftëra në boksion profesionist", ka deklaruar Zogaj për "Epokën e re". Boksieri shqiptar ka filluar të boksojë që nga viti 2015, kurse për një kohë të shkurtër arriti të bëhet dy herë kampion i Republikës së Baden-Wurtemberg në 81 kg, ndërkohë sukseset nuk kanë munguar as në turnet ndërkombëtarë.



Avdyli, në edicionin tjetër te Llapi

PRISHTINË, 1 MAJ - Portieri Ilir Avdyli pritet të rikthehet në futbollin e Kosovës për edicionin e ri. Ish-portieri i shumë skuadrave në Kosovë në edicionin e ardhshëm pritet që sërisht të bartë fanellën e skuadrës së Llapit. Në fakt, Avdyli dhe trajneri Tahir Batatina e kanë zhvilluar një bisedë në rrjetet sociale, ku kanë bërë me dije se në kampionatin e ardhshëm e synojnë së bashku titullin e kampionit.



Avdyli ishte pjesë e Llapit, më pas u transferua te skuadra e Shkëndijës së Tetovës, ndërkohë në ekipin e Kamzës së Shqipërisë.

Vëllaznimi angazhon Sejdiun në vend të Gojanit

GIKOVË, 1 MAJ - Pas përfundimit të ndeshjes Vëllaznimi - Besa, e cila ka përfunduar 0-0, menjëherë është mbajtur një mbledhje nga kryesia e klubit dhe me marrëveshje me trajnerin Arsim Gojani, kanë vendosur ta shkëpusin bashkëpunimin e deritanishëm. "Kryetari i klubit, Agim Cana, menjëherë është interesuar që klubin

mos ta lërë në këtë gjendje dhe ka arritur marrëveshje me Gani Sejdiun, një trajner me premisa të mëdha në kampionatin e Kosovës. Kjo marrëveshje është arritur falë respektit që Sejdiu ka për kryetarin Agim Cana dhe klubin gjakovar. Sejdiu është i gatshëm ta udhëheqë ekipin dhe ta bëjë maksimumin dhe të pamundurën që Vëllaznimi

të mbetet në Superligë, sepse Superliga nuk e ka hijeshinë e duhur pa Vëllazninim", thuhet në njoftimin e skuadrës kuqezi nga Gjakova. Sejdiu e ka kryer të martën edhe stërvitjen e parë me skuadrën e Vëllaznimit, kurse debutimin do ta bëjë më 3 gusht në ndeshjen kundër Vllaznisë nga Pozharani.



Bostoni fiton gjysmëfinalen e parë

BOSTON, 1 MAJ - Kanë nisur ndeshjet gjysmëfinale të "play-off"-it në Konferencën e Lindjes, ku skuadra e Bostonit e mposhti 117-101 Philadelphian në përballjen e parë. Pas 15

minutash të ekuilibruara, skuadra e Celticsit merr frenat e lojës në dorë, duke e komanduar gjatë gjithë kohës takimin, me tre lojtarë që realizuan mbi 20 pikë: Rozier 29,

Tatum 28 dhe Horford 26 pikë, një treshe që bëri diferencën në parket. Philadelphia u përpoq të qëndrojë në lojë me Embiid, që realizoi 31 pikë e 13 rebaunde, por i vetëm e pati të

pamundur ta përballonte skuadrën e Bostonit, që e shfrytëzoi më së miri faktorin fushë. Bostoni udhëheq 1-0 serinë e takimeve gjysmëfinale.



Roma synon përmbysjen kundër Liverpoolit

ROMË, 1 MAJ (ER) - AS Roma është gati ta bëjë befasinë e dytë në Ligën e Kampionëve, duke eliminuar Liverpoolin nga kjo garë, ashtu sikurse e eliminoi edhe Barcelonën në çerekfinale. Ndeshjen e parë Liverpooli e fitoi me rezultat 5-2 në "Anfield". Futbollistët e drejtuar nga Jurgen Klopp tregun një shfaqje të madhe në ndeshjen e parë duke krijuar epërsinë 5-0, por Roma mbajti gjallë shpresat për kualifikim duke shënuar dy gola në Angli. Ekipi italian ka treguar se në "Stadio Olimpico" mund të bëjë mrekulli, pasi e ka mposhtur Barcelonën me rezultat 3-0 dhe arritur kualifikimin. Roma në këtë edicion si vendës e ka mposhtur edhe Shakhtar Donetsk dhe Chelsea. Aktualisht Roma zë vendin e tretë në Serinë A me pikë të barabarta me skuadrën e Lazios. Liverpooli është afër ta sigurojë finalen e madhe pas njëmbëdhjetë vjetëve ku e kishte mposhtur Milanin në finale. Skuadra angleze në dy ndeshjet e fundit në Premier Ligë ka luajtur baras ndaj West Bromwich Albion (2-2) dhe ndaj Stoke Cityt (0-0), por kjo



skuadër në këtë edicion ka treguar paraqitje të mëdha në Ligën e Kampionëve, kurse edhe rezultati 5-2 mund t'i japë një komoditet më të madh sonde në përballjen ndaj Romës. Diego Perotti pritet të mungojë, kurse Kevin Strootmani është në dyshim. Dzeko pritet të luajë

nga fillimi sikurse edhe Manolas, Under dhe Florenzi. Në sulm për mysafirët pritet të luajë treshja Mane-Firmino-Salah, kurse në vend të Oxlade-Chamberlain në mesfushë do të luajë Georgiano Wijnaldum së bashku me Milnerin dhe Hendersonin.

FORMACIONET E MUNDSHME

Roma: Alisson; Fazio, Manolas, Jesus; Florenzi, De Rossi, Gonalons, Kolarov; Under, Nainggolan, Dzeko.
Liverpool: Karius; Alexander-Arnold, Lovren, van Dijk, Roberts; Milner, Henderson, Wijnaldum; Mane, Firmino, Salah.

KH 'Shqiponja' mbështetet me 24 574 euro

GJAKOVË, 1 MAJ - Me iniciativë të grupit të asamblistëve të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), dega Gjakovë dhe me mbështetje të kolegëve të tjerë të Asamblesë Komonale të Gjakovës, në mbledhjen e mbajtur të Kuvendit Komunal u miratua vendimi për subvencionim prej 24 574 eurosh për Klubin e Hendbollit "Shqiponja". "Klubi i cili vazhdon të korrë suksese duke na përfaqësuar edhe në gara ndërkombëtare, duke hyrë në 1/16 e finales të garave të Challenge Cup të Evropës, sukses të cilin deri më sot nuk e ka arritur asnjë ekip i femrave përpos Klubit 'Shqiponja', të cilit klub i urojmë suksese të vazhdueshme", ka shkruar në profilin e vet në "Facebook", asamblisti nga



radhët e PDK-së, njëherësh zv/ministër i MTI-së, Bekim Jupa. I menjëhershëm ka qenë edhe falënderimi i drejtorit të Klubit "Shqiponja" nga Gjakova, prof. Artan Nimani. Ky i fundit ka falënderuar të gjithë asamblistët e Kuvendit Komunal të Gjakovës të cilët kanë

mbështetur kërkesën për sponsorim të iniciuar nga Bekim Jupa, që Klubit "Shqiponja" t'i ndahet shuma në vlerë prej 24 574 eurosh. Me këtë rast Nimani është zotuar se klubi që drejton do ta bëjë krenare në garat ndërkombëtare jo vetëm Gjakovën, por gjithë Kosovën.

SHKURT

Wengeri për Francën refuzon PSG-në

Arsene Wengeri e ka refuzuar ofertën për të marrë një rol në Paris Saint-Germain, sepse dëshiron ta marrë drejtimin e ekipit kombëtar të Francës, sipas "Daily Star". Trajnerit francez i është ofruar roli i presidentit të PSG-së, të cilin e ka refuzuar për shkak se dëshiron ta vazhdojë karrierën e trajnerit. Në fakt, Wengeri, pas largimit nga Arsenal, dëshiron të vazhdojë me ndonjë kombëtare, atë të Francës. Wengeri do të largohet nga Arsenal në përfundim të këtij sezoni, pas plot 22 vjetëve në shërbim të klubit nga Londra.

Mançini, trajner i Italisë

Do të jetë Roberto Mançini trajneri i ri i kombëtares së Italisë. Mediet italiane raportojnë se 53-vjeçari ishte të shtunën në Romë për t'u takuar me zyrtarët e Federatës Italiane të Futbollit, me të cilët arriti pajtimin për t'u ulur në stolin e të kaltërve. Zëvendës-presidenti i komanduar i FIGC-s, Alessandro Costakurta, dhe menaxheri i ekipit italian, Lele Orioli, e kanë takuar Mançinin për më shumë se dy orë në shtëpinë e tij në Romë ku kanë diskutuar gjerë e gjatë për të ardhmen. Trajneri italian do të firmosë një kontratë dyvjeçare, me pagë vjetore katër milionë euro. Mungon vetëm zyrtarizimi, që pritet të vijë pas 13 majit, periudhë kur Mançini ta ketë mbyllur sezonin me Zenit St, Peterburg në Rusi. Debutimi i Mançinit me kombëtaren pritet të vijë më 28 maj, në miqësoren ndaj Arabisë Saudite, që do të luhet në St. Gallen të Zvicrës, ndërsa ndeshja e parë zyrtare do të jetë ajo e Ligës së Kombeve, më 7 shtator ndaj Polonisë.

Cavanit nuk i intereson transferimi në Juventus

Pavarësisht se është përfolur shumë për një rikthim në Itali, por këtë herë me fanellën e Juventusit, Edinson Cavani nuk ka aspak ndërmend të largohet nga Paris Saint-Germain gjatë verës. 31-vjeçari, gjatë një interviste, deklaroi se, pavarësisht se e ardhmja e një lojtari nuk varet vetëm nga dëshira e tij, por edhe nga klubi, gjithsesi nuk ka aspak ndërmend të largohet. Uruguaieni u shpreh se te parisienët ndihet i lumtur dhe se shpreson të vazhdojë të fitojë me këtë skuadër. Gjatë këtij sezoni Cavani ka shënuar 38 gola dhe ka dhënë 12 asistime në 46 ndeshje të luajtura.

Hamilton: Fitova me fat

Pas tri zhgënjimesh në tri garat e para sezonale të Formulës 1, Lewis Hamiltoni është bekuar nga Zoti në garën e zhvilluar ditën e diel në Baku, ku arriti të triumfojë në një pistë ku gjithnjë ishte renditur i pesti. "Nuk besoja se do ta fitoja këtë garë. Ishte një garë emocionuese dhe skuadra bëri një punë fantastike", ka thënë Hamiltoni, duke shtuar: "Valteri e meritonte triumfin dhe e kuptoj keqardhjen e tij. Ai bëri një garë fantastike, ashtu si edhe Vetteli, ndaj nuk e prisja këtë fitore. Vërtet që nuk hoqa dorë asnjë moment, por kjo është Formula 1, që dhuron emocione deri në fund". Falë këtij triumfi, Hamiltoni ka marrë kreun e renditjes së përgjithshme të Formulës 1, duke lënë pas pikërisht Vettelin. Pavarësisht prej kësaj, piloti britanik shprehet se Mercedesi është ende pas Ferrarit dhe se në Azerbajxhan fitoi prej fati. "Ende nuk jemi aty ku duhet dhe ishte fati apo ndërhyrja e makinës së sigurisë ajo që ndryshoi rrjedhën e garës. Duhet punë për të qenë më të shpejtë se rivalët, pasi edhe Red Bulli është përmirësuar ndjeshëm", ka deklaruar Hamiltoni.

Ramosi: Nuk do të ketë korridor për Barcelonën

